



Zbatimi i Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave në Kosovë

(Analizë e kornizës ligjore, praktikës gjyqësore dhe zbatimit institucional)

Autore: Arrita Reznici

Me kontribut të veçantë nga: Anesa Hoxha

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Mbështetur nga:



RRETH IKD

Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi, Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Qershor, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	6
2.	Metodologjia	8
3.	Korniza ligjore	9
4.	Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave	10
5.	Zbatimi i Programit në kuadër të sistemit penal në Kosovë	14
5.1.	Analiza e aktgjykimeve dënuese me kusht të rasteve të dhunës në familje.....	16
5.1.1.	Zbatimi i detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht	16
5.1.2.	Lloji i veprës penale.....	18
5.1.3.	Kohëzgjatja e procedurës	19
5.1.4.	Raporti familjar	20
5.1.5.	Përfaqësimi i viktimave	21
5.1.6.	Pranimi i fajësisë.....	22
5.1.7.	Dënimi i shqiptuar.....	23
5.1.8.	Referimi në Konventën e Stambollit.....	24
6.	Zbatimi i Programi për kryerësit e dhunës në Shërbimin Korrektues të Kosovës.....	24
6.1.	Zbatimi nëpër qendrat korrektuese	25
6.2.	Personat e përfshirë.....	26
6.3.	Mënyra e përfshirjes së të dënuarve.....	26
6.4.	Mënyra e realizimit	27
6.5.	Trajnimi i zyrtarëve.....	27
6.6.	Sfidat e identifikuar.....	28
6.7.	Vlerësimet pozitive	28
7.	Zbatimi i Programi për kryerësit e dhunës në Shërbimin Sprovues të Kosovës.....	29
7.1.	Zbatimi në Shërbimin Sprovues.....	29
7.2.	Trajnimi i zyrtarëve.....	31
7.3.	Sfidat e identifikuar.....	31
8.	Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Programit	32
8.1.	Raportet vjetore mbi trajtimin e kryerësve të dhunës në Kosovë	35
8.1.1.	Raporti për vitin 2024.....	36

8.1.2.	Raporti për vitin 2025	38
9.	Gjetjet kryesore	41
10.	Rekomandimet	43

1. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport i Institutit të Kosovës për Drejtësi analizon kornizën ligjore dhe institucionale që rregullon trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave, nivelin e zbatimit të Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, si dhe rolin e sistemit të drejtësisë në referimin e kryerësve në programe të caktuara. Raporti vlerëson nëse mekanizmat ekzistues ligjorë dhe institucionalë po kontribuojnë në rehabilitimin e kryerësve, parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe forcimin e sigurisë së viktimave.

Në këtë kontekst, në fund të vitit 2023 është lansuar Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, si programi i parë i standardizuar në Kosovë i dedikuar trajtimit të kryerësve të dhunës ndaj grave. Megjithatë, gjetjet e këtij raporti tregojnë se, pavarësisht ekzistimit të Programit dhe bazës ligjore që mundëson referimin e kryerësve në trajtim rehabilitues, ai ende nuk është funksionalizuar në formën e tij të detyrueshme dhe vazhdon të zbatohet kryesisht mbi baza vullnetare.

Analiza e 50 aktgjykimeve të rasteve të dhunës në familje ka treguar se potenciali i sistemit penal për referimin e kryerësve në programe rehabilituese mbetet i pashfrytëzuar. Ndonëse neni 56 i Kodit Penal u mundëson gjykatave që, krahas dënimit me kusht, të shqiptojnë edhe detyrime të veçanta, përfshirë nënshtrimin në programe trajtimi ose rehabilitimi, në asnjërin prej rasteve të analizuara nuk është shqiptuar ndonjë detyrim i tillë. Për më tepër, në asnjë nga rastet e analizuara gjykatat nuk kanë dhënë arsyetim lidhur me mosaplikimin e këtyre masave. Pavarësisht lansimit të Programit në vitin 2023, praktika gjyqësore e analizuar nga IKD nuk reflekton ndonjë ndryshim në qasjen ndaj përdorimit të mekanizmave rehabilitues për kryerësit e dhunës në familje.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se gjykatat, prokurorët, mbrojtësit e viktimave dhe akterët e tjerë të sistemit të drejtësisë duhet të shfrytëzojnë në mënyrë më aktive mekanizmat e paraparë ligjor, duke propozuar dhe shqiptuar detyrime rehabilituese në rastet kur rrethanat e çështjes e arsyetojnë një masë të tillë.

Sa i përket zbatimit praktik të Programit, raporti gjen se ai aktualisht zbatohet vetëm në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe vetëm në Qendrën Korrektuese në Dubravë, duke kufizuar kështu qasjen e personave të tjerë të dënuar në këtë ndërhyrje rehabilituese. Deri në kohën e hartimit të raportit, gjithsej 38 persona të dënuar kanë ndjekur ose janë duke ndjekur Programin.

Ndërkohë, megjithëse Shërbimi Sprovues i Kosovës ka ndërmarrë hapa fillestarë për ngritjen e kapaciteteve profesionale, Programi ende nuk është funksionalizuar në praktikë në kuadër të këtij institucioni. Kjo për IKD-në paraqet një mangësi serioze, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e kryerësve të dhunës në familje dënohen me kusht dhe mbeten në komunitet. Për rrjedhojë, grupi i kryerësve që potencialisht do të përfitonte më së shumti nga ndërhyrjet rehabilituese vazhdon të mbetet jashtë Programit. Në këtë drejtim, IKD rekomandon funksionalizimin e Programit në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës sa më shpejt dhe krijimin e mekanizmave efektivë për referimin e kryerësve në trajtim rehabilitues në komunitet.

Raporti thekson gjithashtu se pjesëmarrja në programet për kryerësit e dhunës nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si alternativë ndaj ndjekjes dhe procedimit penal të veprave të dhunës. Përkundrazi, këto programe duhet të funksionojnë si mekanizëm plotësues i sistemit penal, me fokus në rehabilitimin e kryerësve, uljen e rrezikut të recidivizmit dhe forcimin e sigurisë së viktimave.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me mungesën e një kornize të plotë nënligjore për organizimin, standardizimin, monitorimin dhe vlerësimin e Programit. Raporti identifikon gjithashtu paqartësi lidhur me kompetencat institucionale për hartimin e akteve të tilla që rregullojnë Programin. Për këtë arsye, IKD vlerëson se Ministria e Drejtësisë, përmes Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor që rregullon organizimin, zbatimin, monitorimin dhe standardet e Programit.

Një pjesë e rëndësishme e raportit fokusohet në monitorimin dhe vlerësimin e Programit. Analiza ka evidentuar se Ministria e Drejtësisë nuk ka krijuar një bazë të dedikuar të të dhënave për monitorimin e kryerësve që referohen dhe ndjekin Programin, siç parashihet në dokumentet strategjike. Megjithëse Databaza Nacionale për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje përmban të dhëna bazike mbi rastet dhe kryerësit, ajo nuk është konceptuar si mekanizëm për monitorimin e pjesëmarrjes, progresit, rezultateve dhe efektivitetit të Programit. Mungesa e një sistemi të tillë kufizon aftësinë e institucioneve për të zhvilluar politika të bazuara në evidencë dhe për të vlerësuar ndikimin e Programit në parandalimin e përsëritjes së dhunës.

Po ashtu, raporti evidenton mungesë transparence në raportimin institucional. Raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të Programit nuk janë publikuar nga Ministria e Drejtësisë, ndonëse ato janë hartuar. Analiza e këtyre raporteve ka evidentuar mospërputhje ndërmjet burimeve të ndryshme institucionale lidhur me numrin e pjesëmarrësve në Program, si dhe kufizime të rëndësishme metodologjike që ndikojnë në besueshmërinë e vlerësimit të rezultateve. Për më tepër, procesi i monitorimit nuk ka përfshirë perspektivën e viktimave, për shkak të mungesës së mekanizmave adekuatë për mbledhjen e sigurt të të dhënave nga ato. Kjo kufizon mundësinë për të vlerësuar në mënyrë të plotë ndikimin e Programit në sigurinë e viktimave dhe në parandalimin e përsëritjes së dhunës.

Megjithëse raportet e vlerësimit për vitet 2024 dhe 2025 identifikojnë përmirësime në reduktimin e disa sjelljeve abuzive, rritjen e vetëdijesimit dhe marrjen e përgjegjësisë nga pjesëmarrësit, ato evidentojnë gjithashtu se forma të caktuara të kontrollit, xhelozisë, posesivitetit, stereotipeve gjimore dhe fajësimit të viktimave vazhdojnë të jenë të pranishme edhe pas përfundimit të Programit.

Së fundi, gjatë procesit të konsultimit për hartimin e këtij raporti, përfaqësues të gjyqësorit kanë vlerësuar se korniza aktuale ligjore mund të forcohet përmes ndryshimeve në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, me qëllim që pjesëmarrja në Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave të parashihet si masë e detyrueshme në rastet e dënimeve për vepra penale që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.

2. Metodologjia

Ky raport është hartuar mbi bazën e një qasjeje të kombinuar metodologjike, e cila ka përfshirë analizën normative, analizën e praktikës gjyqësore, mbledhjen e të dhënave institucionale dhe konsultimin me akterët relevantë.

Në fazën fillestare është realizuar një analizë e kornizës ligjore dhe politike që rregullon trajtimin e kryerësve të dhunës në Kosovë. Kjo analizë ka përfshirë legjislacionin penal dhe aktet e tjera nënligjore, dokumentet strategjike kombëtare, Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, si dhe standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, me fokus të veçantë në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe praktikën monitoruese të GREVIO-s.

Një komponent i rëndësishëm i hulumtimit ka qenë analiza e praktikës gjyqësore. Për këtë qëllim, IKD ka analizuar 50 aktgjykime dënuese me kusht të nxjerra nga gjykatat themelore dhe degët e tyre gjatë periudhës 2021–2025. Aktgjykimet janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga vendimet e publikuara në ueb-faqen zyrtare të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përzgjedhja e rasteve me dënim me kusht është bërë në mënyrë të qëllimshme, duke pasur parasysh se Kodi Penal i Republikës së Kosovës u mundëson gjykatave që, krahas dënimit me kusht, të shqiptojnë edhe detyrime të veçanta rehabilituese, përfshirë nënshtrimin në programe trajtimi dhe rehabilitimi. Analiza e aktgjykimeve ka synuar të vlerësojë nëse gjykatat po shfrytëzojnë mekanizmat ligjorë për referimin e kryerësve në programe rehabilituese, si dhe nëse ka pasur ndryshime në praktikën gjyqësore pas lansimit të Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave në fund të vitit 2023. Për secilin aktgjykim janë analizuar edhe elemente të tjera si kualifikimi juridik i veprës penale, kohëzgjatja e procedurës, raporti familjar ndërmjet palëve, përfaqësimi procedural i viktimës, pranimi i fajësisë nga i akuzuari, lloji i dënimit të shqiptuar, referimet në instrumente ndërkombëtare, veçanërisht në Konventën e Stambollit.

Me qëllim të vlerësimit të nivelit të zbatimit të Programit Kombëtar në praktikë, IKD ka kërkuar të dhëna nga institucionet përgjegjëse për zbatimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e programit. Në këtë drejtim, janë kërkuar informata nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës lidhur me numrin e personave të përfshirë në program, mënyrën e zbatimit, kapacitetet institucionale, trajnimet e stafit, sfidat e hasura dhe vlerësimet mbi rezultatet e arritura. Po ashtu, janë kërkuar të dhëna edhe nga Ministria e Drejtësisë, përkatësisht nga Zyra e Koordinatorit Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, lidhur me monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave.

Krahas këtyre, IKD ka zhvilluar edhe një takim konsultativ me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e programit dhe akterë të tjerë që veprojnë në këtë fushë. Ky proces ka mundësuar identifikimin e sfidave praktike në zbatimin e programit, diskutimin e përvojave institucionale, evidentimin e pengesave operative dhe mbledhjen e rekomandimeve për përmirësimin e mekanizmave ekzistues.

3. Korniza ligjore

Sa i përket legjislacionit vendor në Kosovë, trajtimi i dhunës në familje rregullohet me anë të Ligjit Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore¹ i cili ka shfuqizuar Ligjin për Mbrojtjen nga dhuna në familje të vitit 2010. Ky ligj ka për qëllim të parandalojë dhe trajtojë dhunën ndaj grave, dhunën në familje dhe dhunën në baza gjimore, të mbrojtë dhe të kontribuojë në eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, promovimin e barazisë gjimore dhe fuqizimin e grave si dhe të ndërtojë mekanizmat e nevojshëm për ofrimin e mbështetjes ndaj viktimave të të gjitha formave të dhunës të rregulluara me këtë ligj.² Në anën tjetër, Kodi Penal i Republikës së Kosovës i hyrë në fuqi në vitin 2019 për dallim nga kodet e mëparshme, tashmë e kriminalizon dhunën në familje si vepër të veçantë penale.³ Kjo vepër penale dënohet me gjobë dhe me burgim deri në 3 vjet. Po ashtu me këtë nen janë të parapara edhe llojet e dhunës, ku është paraparë dhuna ose keqtrajtimi fizik, psikologjik, ekonomik dhe seksual.

Krahas kësaj, trajtimi i dhunës në familje në vendin tonë rregullohet përmes një kornize ligjore të ndërtuar mbi standardet ndërkombëtare. Njëri nga këto instrumente është edhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje (e njohur si Konventa e Stambollit) e cila synon parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen penale të kryerësve. Kjo Konventë që nga viti 2020 është inkuadruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁴

Konventa e Stambollit përcakton detyrime specifike për shtetet palë në lidhje me ngritjen e programeve parandaluese dhe të trajtimit për kryerësit e dhunës në familje. Në nenin 16 të saj kërkohet krijimi ose mbështetja e programe që parandalojnë kryerësit e dhunës në familje nga përsëritja e veprës penale dhe që nxisin ndryshimin e modeleve të sjelljes së dhunshme, ku shprehimisht thuhet se “palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë edukimin e autorëve të dhunës në familje që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes.”⁵ Përveç kësaj, neni 16, paragrafi 3 thekson se “palët duhet të garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e njeriut të viktimave janë shqetësimi parësor dhe se, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.”⁶

¹ Ligji Nr. 08/L-185 Për Parandalimin Dhe Mbrojtjen Nga Dhuna Në Familje Dhuna Ndaj Grave Dhe Dhuna Në Baza Gjimore (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2691>)

² Ligji Nr. 08/L-185 Për Parandalimin Dhe Mbrojtjen Nga Dhuna Në Familje Dhuna Ndaj Grave Dhe Dhuna Në Baza Gjimore, neni 1.

³ Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 248.

⁴ Amendamenti nr. 26 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, 25.09.2020. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>)

⁵ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, neni 16, par.1.

⁶ Po aty, par. 3.

Në drejtim të Programit për trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj grave, në nenin 56 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, përcaktohen llojet e detyrimeve që mund të shqiptohen me rastin e dënimit me kusht.⁷ Një ndër pesëmbëdhjetë detyrimet e përcaktuara është edhe nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit.⁸

Nga ana tjetër, deri në hyrjen në fuqi të ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, ka qenë në fuqi Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesve të dhunës në familje.⁹ Megjithatë, me shfuqizimin e Ligjit Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, ka pushuar së ekzistuari edhe baza ligjore mbi të cilën është nxjerrë ky akt nënligjor. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 është mbështetur edhe në Ligjin Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, si dhe në Rregulloren Nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat po ashtu janë të shfuqizuara. Si rezultat, aktualisht mungon një akt nënligjor i vlefshëm që rregullon në mënyrë specifike trajtimin psikosocial të kryesve të dhunës në familje.

Ndonëse Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore ka paraparë detyrimin që Qeveria e Republikës së Kosovës, gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse, deri më tani nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për hartimin dhe miratimin e akteve përkitazi me Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave.

Ndërsa, me qëllim të rritjes së përpjekjes për të garantuar të jetuarit me dinjitet dhe pa dhunë, Kosova ka miratuar edhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026.¹⁰ Strategjia ka përcaktuar disa objektiva strategjike, ndër të cilat edhe specifikisht atë që përcakton “Krijimin dhe zbatimin e programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës”, në kuadër të objektivës 1 – Parandalimi dhe identifikimi i dhunës¹¹, duke theksuar se trajtimi psiko-social i kryerësve të dhunës gjatë kryerjes së ndëshkimit dhe përfshirja në programe adekuate rehabilitimi, është domosdoshmëri.

4. Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave

Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave (tutje: Programi) është një iniciativë e ndërtuar mbi parimet e ndërhyrjes strategjike dhe rehabilitimit psiko-social për ata që kanë kryer dhunë ndaj partneres grua.¹² Programi ka për qëllim të ndryshojë sjelljet e dhunshme të kryerësve

⁷ Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 56.

⁸ Po aty, par. 1.2.

⁹ Udhëzim Administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje, i cili është miratuar në mbledhjen e 91 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me vendimin nr. 03/91 të datës 12.09.2012.

¹⁰ <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/03/ALB-Strategjia-Komb%C3%ABtare-p%C3%ABr-Mbrojtje-nga-Dhuna-n%C3%AB-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>

¹¹ Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022 – 2026, fq. 38 – 39.

¹² Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës Ndaj Grave, Fletushkë nga Ministria e Drejtësisë (<https://rm.coe.int/leaflet-on-perpetrators-programme-on-the-web-kosovo-alb/1680ae44f7>).

nëpërmjet një rrugëtimi transformues që çon drejt adoptimit të sjelljeve jo të dhunshme dhe të respektueshme në marrëdhëniet ndërpersonale.¹³ Edhe pse theksi i Programit është reformimi dhe rehabilitimi i kryerësve, në thelb, synimi përfundimtar qëndron në krijimin e një mjedisi të sigurt për të mbijetuarat, ofrimi i mbështetjes dhe sigurisë se nevojshme për t'u fuqizuar dhe ecur përpara.¹⁴

Ky program është lansuar në fund të vitit 2023.¹⁵ Para lansimit të këtij programi, gjetjet kishin treguar se barra kryesore për ofrimin e programeve për trajtimin e kryerësve të dhunës bie mbi institucionet shëndetësore publike, në veçanti mbi qendrat e shëndetit mendor, të cilat zbatojnë të dy llojet e ndërhyrjeve.¹⁶ Këto institucione përbëjnë mekanizmin primar institucional për adresimin terapeutik të sjelljeve të dhunshme.¹⁷ Në raportet bazë të vlerësimit, GREVIO vuri në dukje se programet për kryerësit e dhunës që fokusohen në trajtimin mjekësor janë problematike, pasi ato duket se tregojnë se dhuna do të përfundojë nëse tejkalohet varësia nga droga ose alkooli ose problemi i shëndetit mendor, në vend që të promovohet ndryshimi i sjelljes tek kryerësit e dhunës në bazë të pranimit të përgjegjësisë për dhunën e kryer.¹⁸

Në këtë drejtim, GREVIO ka theksuar se trajtimi i problemeve të varësisë ose i çrregullimeve të shëndetit mendor mund të jetë një komponent i rëndësishëm mbështetës, por nuk duhet të zëvendësojë programet e specializuara për kryerësit e dhunës. Sipas këtij mekanizmi monitorues, efektiviteti i programeve duhet të matet përmes aftësisë së tyre për të nxitur marrjen e përgjegjësisë nga kryerësit, për të ndryshuar modelet e sjelljes së dhunshme dhe, mbi të gjitha, për të kontribuar në rritjen e sigurisë së viktimave dhe parandalimin e përsëritjes së dhunës.¹⁹

Programet për kryerësit e dhunës mund të zbatohen në kontekste të ndryshme institucionale apo komunitare, varësisht nga përgjegjësia apo procedura në të cilën është i përfshirë personi. Për këtë arsye, IKD vlerëson se është e domosdoshme që organizimi, mënyra e zbatimit dhe standardet e ofrimit të këtyre programeve të rregullohen qartë përmes akteve nënligjore. Një rregullim i tillë duhet të përcaktojë jo vetëm përgjegjësitë institucionale, por edhe kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushin subjektet e tjera që mund të përfshihen në zbatimin e programit. Kjo do të siguronte që programi në cilindo kontekst që zbatohet, përfshirë atë komunitar, të zbatohet në përputhje me standardet e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës në Familje, si program i standardizuar dhe zyrtar, pa mundësi devijimi nga metodologjia dhe përmbajtja e tij.

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Ministria e Drejtësisë: Lancohet Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, nëntor 2023 (<https://md.rks-gov.net/lajmet/lancohet-programi-kombetar-per-kryeresit-e-dhunes-ndaj-grave/>).

¹⁶ Vlerësimi i përafritimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit, Sekretariati i mekanizmit monitorues të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, nëntor 2022, fq. 39. (<https://rm.coe.int/kosovo-assessment-report-istanbul-convention-sqi/1680a9203f>).

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty, fq. 39-40.

Sa i përket aspektit institucional, Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore, në nenin 36, paragrafi 4, përcakton se Ministria përgjegjëse për Shëndetësi, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenie sociale dhe institucionet përkatëse, përgatit dhe propozon për miratim në Qeveri aktin nënligjor me të cilin përcaktohet mënyra dhe vendi i zbatimit të trajtimit psikosocial. Ndërkaq, paragrafi 5 i të njëjtit nen obligon Ministrinë përgjegjëse për Shëndetësi të themelojë mekanizmat e nevojshëm institucionalë për trajtimin psikosocial të kryerësve të dhunës. IKD vlerëson se këto dispozita i referohen masës mbrojtëse të trajtimit psikosocial, e cila shqiptohet nga gjykata si pjesë e urdhrin mbrojtës, me qëllim parandalimin e dhunës, mbrojtjen dhe sigurinë e viktimës dhe personave të tjerë të ekspozuar ndaj dhunës, si dhe eliminimin e rrethanave që mund të ndikojnë në përsëritjen e saj. Në këtë kuptim, kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë lidhen kryesisht me organizimin dhe ofrimin e trajtimit psikosocial në rastet kur kryerësit paraqesin nevoja specifike shëndetësore, përfshirë problemet e varësisë apo çrregullimet e shëndetit mendor, në përputhje me mandatin e saj ligjor. Kjo formë shkon edhe në përputhje me frymën e akteve paraprake që kanë rregulluar këtë çështje, me ç'rast ishte përcaktuar se ndërhyrjet psiko-sociale mund të realizohen nga institucionet shëndetësore, institucionet sociale dhe ofruesit e licencuar të shërbimeve sociale, përfshirë organizatat e shoqërisë civile.²⁰ Në rastet kur kryerësit paraqesin probleme të varësisë, trajtimi mjekësor duhet të ofrohet nga institucionet shëndetësore përkatëse, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore.²¹

Është e rëndësishme të bëhet dallim i qartë ndërmjet trajtimit psikosocial të paraparë në nenin 36 të Ligjit Nr. 08/L-185 dhe Programit për Kryerësit e Dhunës në Familje. Trajtimi psikosocial sipas këtij neni paraqet një masë mbrojtëse që shqiptohet nga gjykata në kuadër të urdhrin mbrojtës, me qëllim parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës. Në këto raste, personi nuk është domosdoshmërisht subjekt i një procedure penale apo i një dënimi penal, prandaj përgjegjësitë institucionale lidhen kryesisht me ofrimin e shërbimeve psikosociale dhe shëndetësore sipas nevojave të identifikuar. Në anën tjetër, Programi për Kryerësit e Dhunës në Familje është një mekanizëm rehabilitues me karakter më të gjerë, i cili zbatohet në kuadër të sistemit të drejtësisë penale ndaj personave të dënuar për vepra penale të dhunës në familje, përfshirë rastet kur dënimi ekzekutohet me kusht. Qëllimi i programit synon ndryshimin e modeleve të sjelljes, marrjen e përgjegjësisë për veprën penale dhe uljen e rrezikut të përsëritjes së dhunës. Për këtë arsye, edhe pse trajtimi psikosocial mund të përbëjë një komponent të Programit për Kryerësit e Dhunës në Familje, këto janë dy mekanizma të ndryshëm për nga natyra juridike, qëllimi, grupi i synuar dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tyre.

Për rrjedhojë, akti nënligjor që rregullon mënyrën e zbatimit të këtij Programi duhet të nxirret nga autoriteti kompetent përgjegjës për koordinimin e politikave në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje. Ligji Nr. 08/L-185 përcakton qartë se “Koordinatori/ja Kombëtar/e për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjimore është autoriteti më i lartë

²⁰ Udhëzim Administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryesit të dhunës në familje, neni 4, par. 1.

²¹ Po aty, par. 2.

institucional përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga ligji dhe Konventa e Stambollit”. Po ashtu, Rregullorja (QRK) Nr. 37/2024 për Organizimin dhe Funksionimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, në nenin 5, përcakton se “Zyra e Koordinatorit Kombëtar ofron mbështetje në hartimin e legjislacionit për qasje në drejtësi, përfshirë mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore”. Duke qenë se qëllimi i Programit për Kryerësit e Dhunës në Familje është mbrojtja e viktimave dhe parandalimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe dhunës në baza gjinore, ai lidhet drejtpërdrejt me mandatin koordinues dhe politikëbërës të Koordinatorit Kombëtar. Për këtë arsye, IKD vlerëson se Ministria e Drejtësisë, përmes Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor që rregullon organizimin, zbatimin, monitorimin dhe standardet e Programit për Kryerësit e Dhunës në Familje, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë institucionale dhe kushtet për zbatimin e tij.

Në aspektin praktik, IKD gjen se këto programe mund të ofrohen brenda sistemit korrektues, në institucionet e vuajtjes së dënimit me burg, si dhe në kuadër të shërbimeve sprovuese për personat e dënuar për vepra të dhunës ndaj grave. Në këto raste, pjesëmarrja në program lidhet me një vendim gjyqësor apo plan individual rehabilitimi dhe monitorohet nga autoritetet përkatëse. Ndërsa, programet mund të zhvillohen edhe në komunitet, ku kryerësit e dhunës marrin pjesë mbi baza vullnetare. Dy organizata të shoqërisë civile, Qendra SIT në Prishtinë dhe Shtëpia e Sigurt në Gjakovë, kanë zhvilluar programe pilot të bazuara në trajtim psiko-kognitiv. Megjithatë, programet e drejtuara nga OJQ-të janë përballur me mbështetje financiare të kufizuar, çka ka ndikuar në kapacitetin e tyre për të siguruar zbatim të qëndrueshëm dhe shtrirje më të gjerë.²²

Në kuadër të procedurave të saj të monitorimit, GREVIO ka theksuar se shtetet duhet të sigurojnë jo vetëm rritjen e numrit të programeve për trajtimin e kryerësve të dhunës, por edhe diversifikimin e tyre, në mënyrë që ato të jenë të qasshme në kontekste të ndryshme institucionale dhe komunitare.²³ Kjo përfshin ofrimin e programeve si për personat që referohen në mënyrë të detyrueshme nga sistemi i drejtësisë penale, ashtu edhe për ata që kërkojnë trajtim mbi baza vullnetare, si brenda institucioneve korrektuese ashtu edhe jashtë tyre. Në këtë kuptim, kombinimi i programeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare vlerësohet si një nga mekanizmat më efektivë për zgjerimin e qasjes në trajtim, reduktimin e recidivizmit dhe rritjen e sigurisë së viktimave.

Megjithatë, gjetjet e këtij raporti të IKD-së tregojnë se në Kosovë programi për trajtimin e kryerësve të dhunës ende nuk është funksionalizuar në formën e tij të detyrueshme, por vazhdon të zbatohet vetëm mbi baza vullnetare. Kjo situatë vazhdon pavarësisht rëndësisë së theksuar që i atribuohet programeve të detyrueshme në standardet ndërkombëtare dhe pavarësisht potencialit të

²² Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit, Sekretariati i mekanizmit monitorues të Konventës së Këshillit të Evropës, fq. 39.

²³ Kurrikula për trajnimin e profesionistëve për ofrimin e programeve për kryerësit e dhunës në familje në Republikën e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, fq. 29. (<https://md.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/07/E366CD3B-E6B1-4250-9748-1692A1A6D636.pdf>)

tyre për të ndikuar në ndryshimin e sjelljes së kryerësve, uljen e rrezikut të përsëritjes së dhunës dhe forcimin e mbrojtjes së viktimave.

Në anën tjetër është shumë me rëndësi të theksohet se pjesëmarrja në programet për kryerësit e dhunës nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si alternativë ndaj ndjekjes dhe procedimit penal të veprave të dhunës.²⁴

Po ashtu, IKD thekson se zhvillimi dhe funksionalizimi i programeve për kryerësit e dhunës nuk duhet të realizohet në dëm të shërbimeve për viktimat. Në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe qasjen e orientuar drejt sigurisë së viktimave, financimi i programeve për kryerësit duhet të sigurohet në mënyrë të tillë që të mos cenohet, zvogëlohet apo ndikohet negativisht në buxhetin dhe kapacitetet e shërbimeve të dedikuara për viktimat e dhunës. Sigurimi i mbështetjes, mbrojtjes dhe fuqizimit të viktimave duhet të mbetet prioritet parësor i politikave publike dhe i alokimit të burimeve financiare.

5. Zbatimi i Programit në kuadër të sistemit penal në Kosovë

Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave është konceptuar si program rehabilitimi psiko-social që synon ndryshimin e sjelljeve të dhunshme, rritjen e përgjegjësisë së kryerësve dhe parandalimin e përsëritjes së dhunës. Për shkak të natyrës dhe objektivave të tij, ky program ndërlihet drejtpërdrejt me sistemin penal dhe, në veçanti, me urdhrin për të përmbushur detyrime të caktuara të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim, neni 56 i Kodit Penal shprehimisht përcakton që “dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e mëposhtme: [...] 1.2. nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;”²⁵ Kjo nënkupton se parashihet mundësia që, me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, gjykata t’i caktojë të dënuarit një ose më shumë detyrime, përfshirë edhe nënshtrimin në programe trajtimi ose rehabilitimi. Edhe pse Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave është lansuar në fund të vitit 2023, pra pas hyrjes në fuqi të Kodit Penal, formulimi i kësaj dispozite është mjaftueshëm i gjerë për të përfshirë programe rehabilituese të krijuara edhe pas miratimit të Kodit.

Për rrjedhojë, ekziston një bazë ligjore që gjykatat, në rastet e përshtatshme, të urdhërojnë pjesëmarrjen e kryerësve në Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave si një nga detyrimet e lidhura me dënimin me kusht. Kjo qasje është në përputhje edhe me qëllimin e vetë detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht, me ç’rast kërkohet që gjatë caktimit të detyrimeve, gjykata në veçanti të merr parasysh moshën e personit të dënuar; gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore; mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën; motivet për kryerjen e veprës penale; sjelljen e tij pas kryerjes së

²⁴ Po aty.

²⁵ Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, neni 56.

veprës penale; sjelljen e tij të kaluar; rrethanat e tij personale dhe ato në lidhje me familjen; dhe rrethanat tjera që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit dhe kohëzgjatjes së mbikëqyrjes.²⁶

Rëndësia e kësaj dispozite bëhet edhe më e theksuar në rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke qenë se shumë kryerës nuk e pranojnë përgjegjësinë për sjelljet e tyre ose nuk shfaqin gatishmëri për t'u përfshirë vullnetarisht në programe trajtimi. Rrjedhimisht mbështetja vetëm në pjesëmarrjen vullnetare rrezikon të lërë jashtë trajtimit një numër të konsiderueshëm personash që paraqesin rrezik për përsëritjen e dhunës. Në këtë drejtim, mundësia që pjesëmarrja në program të urdhërohet nga gjykata merr rëndësi të veçantë si mekanizëm për rehabilitimin e kryerësve, parandalimin e recidivizmit dhe sigurinë e viktimave.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e dënimeve të shqiptuara për veprën penale të dhunës në familje janë dënime me kusht.²⁷ Për rrjedhojë, një numër i madh i kryerësve mbeten të përfshirë në komunitet dhe nëse pjesëmarrja në Programin Kombëtar do të caktohej si detyrim në kuadër të dënimit me kusht, trajtimi rehabilitues do të arrinte tek kategoria më e madhe e kryerësve të dhunës, e cila aktualisht mbetet jashtë programeve të specializuara.

Duke pasur parasysh këtë, IKD vlerëson se ekziston potencial i konsiderueshëm për përdorimin më të gjerë të mekanizmave ligjorë që mundësojnë referimin e kryerësve në programe trajtimi dhe rehabilitimi. Në këtë drejtim, rol të rëndësishëm kanë të gjithë akterët e përfshirë në procedurën penale. Kodi i Procedurës Penale përcakton se, me rastin e mbajtjes së seancës për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë, “prokurori i shtetit, i akuzuari apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë mbajtjen e seancës me qëllim të paraqitjes së çështjeve të rëndësishme për caktimin e dënimit”.²⁸ Po ashtu, në kuadër të kësaj seance, prokurori i shtetit, i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, viktimata, mbrojtësi i viktimave ose përfaqësuesi i viktimës mund t'i paraqesin gjykatës deklarata, argumente dhe rrethana që konsiderohen relevante për përcaktimin e një dënimi të përshtatshëm”.²⁹

Prandaj, IKD vlerëson se prokurorët e shtetit, mbrojtësit e viktimave dhe akterët e tjerë relevantë duhet të adoptojnë një qasje më proaktive në rastet kur rrethanat e çështjes e arsyetojnë një masë të tillë. Në rastet kur ekziston mundësia që gjykata të shqiptojë dënim me kusht, këta akterë duhet të propozojnë që, krahas dënimit, të caktohet edhe detyrimi nga neni 56 i Kodit Penal për nënshtrim në programe trajtimi ose rehabilitimi, përkatësisht referimi në Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave. Një qasje e tillë do të mundësonte shfrytëzimin efektiv të mekanizmave ekzistues ligjorë për të rritur përfshirjen e kryerësve në programe rehabilituese, për të parandaluar përsëritjen e dhunës dhe për të forcuar mbrojtjen e viktimave.

Nga perspektiva e mbrojtjes së viktimave, zbatimi i programit përmes detyrimeve të shqiptuara nga gjykata nuk duhet të shihet vetëm si masë rehabilituese ndaj kryerësit, por edhe si mekanizëm

²⁶ Po aty, neni 55, par. 3.

²⁷ Rezniciq A., “Konventa e Stambollit në aktgjykimet e gjykatave në Kosovë”, shtator 2022 (https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2023/03/Konventa-e-Stambollit-ne-aktgjykimet-e-gjykatave-ne-Kosove_ALB.pdf).

²⁸ Kodi nr. 08/1-032 i Procedurës Penale, neni 356, par. 2.

²⁹ Po aty, par. 7.

për menaxhimin e rrezikut, parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe rritjen e sigurisë së viktimave. Për këtë arsye, IKD ka analizuar praktikën gjyqësore për të vlerësuar nëse gjykatat po e përdorin potencialin që ofron neni 56 i Kodit Penal për referimin e kryerësve në programe trajtimi dhe rehabilitimi.

Vlen të theksohet se, gjatë procesit të hartimit të këtij raporti, IKD ka zhvilluar takime konsultative me akterët kryesorë institucionalë të përfshirë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Në kuadër të këtyre diskutimeve, përfaqësues të gjyqësorit kanë shprehur qëndrimin se korniza aktuale ligjore ka nevojë t'i nënshtrohet ndryshimeve në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, me qëllim që pjesëmarrja në Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave të parashihet si detyrim i detyrueshëm në rastet e dënimeve për vepra penale që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.³⁰ Sipas këtij qëndrimi, një zgjidhje e tillë do të siguronte qasje më të unifikuar në praktikën gjyqësore dhe do të rriste ndjeshëm numrin e kryerësve të përfshirë në programe rehabilituese të specializuara.

5.1. Analiza e aktgjykimeve dënuese me kusht të rasteve të dhunës në familje

Për qëllime të këtij raporti, IKD ka analizuar 50 aktgjykime të formës së prerë të nxjerra nga gjykatat themelore dhe degët e tyre gjatë periudhës 2021–2025. Përzgjedhja e këtyre aktgjykimeve është bërë në mënyrë rastësore përmes publikimeve në ueb-faqen zyrtare të sistemit gjyqësor,³¹ me synim sigurimin e një mostre të praktikës aktuale gjyqësore.

Analiza ka përfshirë elemente të ndryshme të praktikës gjyqësore, si llojin e veprës penale, kohëzgjatjen e procedurës, raportin familjar ndërmjet palëve, përfaqësimin e viktimave, pranimin e fajësisë, llojin e dënimit të shqiptuar dhe referencat ndaj Konventës së Stambollit. Megjithatë, fokusi kryesor i analizës ka qenë zbatimi i detyrimeve të parapara në nenin 56 të Kodit Penal dhe në veçanti, detyrimi për nënshttrimin në programin e rehabilitimit në rastet e dënimit me kusht.

5.1.1. Zbatimi i detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht

Roli i gjykatave në aktivizimin e mekanizmave të tjerë përmes vendimeve gjyqësore është i një rëndësie të veçantë. Në këtë drejtim, neni 56 i Kodit Penal u mundëson gjykatave që, me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, të caktojnë një ose më shumë detyrime që synojnë rehabilitimin e të dënuarit, adresimin e faktorëve që kanë ndikuar në kryerjen e veprës penale dhe parandalimin e përsëritjes së saj.

³⁰ Takim konsultativ i IKD me akterët kryesorë institucionalë përgjegjës për zbatimin e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, Prishtinë, 12.06.2026.

³¹ Aktgjykimet e publikuara në webfaqen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës - <https://www.gjyqesori-rks.org/aktgjykimet/>.

Megjithatë, analiza e 50 aktgjykimeve të përfshira në këtë raport tregon se në asnjërin prej rasteve ku është shqiptuar dënim me kusht nuk është caktuar ndonjë nga detyrimet e parapara me nenin 56 të Kodit Penal.



Grafika 1. Zbatimi i detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht

Kjo gjetje është veçanërisht domethënëse duke pasur parasysh se legjislacioni penal ofron bazë ligjore për shqiptimin e detyrimeve shtesë, përfshirë edhe referimin e kryerësve në programe rehabilitimi. Për rrjedhojë, nga rastet e analizuara rezulton se gjykatat kanë zgjedhur ta kufizojnë dënimin me kusht vetëm në pezullimin e ekzekutimit të dënimit, pa e shoqëruar atë me masa shtesë rehabilituese apo mbikëqyrëse. Nga perspektiva e parandalimit të dhunës, mungesa e detyrimeve rehabilituese nënkupton se nuk janë shfrytëzuar mekanizmat ligjorë që synojnë adresimin e shkaqeve dhe faktorëve që kanë ndikuar në sjelljen e dhunshme të kryerësit. Në veçanti në rastet e dhunës në familje, ku recidivizmi dhe modelet e vazhdueshme të kontrollit dhe pushtetit konsiderohen faktorë të njohur të rrezikut, mosaktivizimi i këtyre masave kufizon potencialin rehabilitues të dënimit dhe dobëson funksionin parandalues të tij.

Po ashtu, analiza e aktgjykimeve tregon se në asnjërin nga rastet nuk është dhënë arsyetim specifik lidhur me mosshqiptimin e detyrimeve të parapara me nenin 56 të Kodit Penal. Mungesa e një arsytimi të tillë kufizon mundësinë për të vlerësuar nëse gjykata ka analizuar nevojat rehabilituese të kryerësit, rrezikun e përsëritjes së veprës penale, si dhe nevojën për masa shtesë që do të kontribuonin në mbrojtjen e viktimës dhe parandalimin e dhunës në të ardhmen. Në aspektin e individualizimit të dënimit, arsyetimi i qartë dhe i detajuar përbën një element thelbësor të vendimmarrjes gjyqësore, duke qenë se shërben për të dëshmuar se gjykata ka vlerësuar rrethanat konkrete të rastit, karakteristikat e kryerësit dhe nevojën për ndërhyrje rehabilituese, duke siguruar që dënimi të jetë jo vetëm proporcional, por edhe efektiv në arritjen e qëllimeve të tij parandaluese dhe rehabilituese.

Kurse, veçanërisht nga perspektiva e mbrojtjes së viktimave, kjo gjetje merr rëndësi të veçantë. Duke qenë se pjesa më e madhe e kryerësve të dënuar me kusht mbeten në komunitet dhe vazhdojnë të jenë potencialisht në kontakt me viktimat, mungesa e detyrimeve rehabilituese nënkupton se nuk po shfrytëzohen plotësisht instrumentet ligjore që synojnë ndryshimin e sjelljes së kryerësve dhe reduktimin e rrezikut të përsëritjes së dhunës.


Për këtë arsye, IKD vlerëson se potenciali i nenit 56 të Kodit Penal për referimin e detyrueshëm të kryerësve në programe trajtimi dhe rehabilitimi, përfshirë Programin Kombëtar për Trajtimin e Kryerësve të Dhunës ndaj Grave, mbetet i pashfrytëzuar në praktikën gjyqësore. Duke pasur parasysh numrin e lartë të dënimeve me kusht të shqiptuara në rastet e dhunës në familje, përdorimi më i shpeshtë i këtyre detyrimeve do të mund të përbente një nga mekanizmat më efektivë për funksionalizimin e programit në praktikë, duke e kthyer atë në program për personat që referohen në mënyrë të detyrueshme nga sistemi i drejtësisë.

5.1.2. Lloji i veprës penale

Pothuajse të gjitha aktgjykimet e analizuara lidhen me veprën penale të dhunës në familje, të paraparë me nenin 248 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kjo tregon se rastet e trajtuara në këtë mostër janë kryesisht të natyrës së drejtpërdrejtë të dhunës fizike, psikologjike apo formave

të tjera të dhunës brenda marrëdhënieve familjare, ashtu siç përcaktohet në dispozitat përkatëse penale.


Vetëm një rast është kualifikuar si “Shkelja e detyrimeve familjare” sipas nenit 244 të Kodit Penal. Kjo diferencë tregon se, në praktikë, rastet e paraqitura para gjykatave kanë qenë kryesisht të lidhura me elemente të qarta të dhunës, ndërsa shkeljet e detyrimeve familjare përbëjnë një përqindje minimale në këtë mostër.



Grafika 2. Lloji i veprës penale për të cilën është akuzuar kryerësi në aktgjykimet e gjykatave themelore

5.1.3. Kohëzgjatja e procedurës

Sa i përket kohëzgjatjes së procedurës, analiza e 50 rasteve tregon se mesatarisht kanë kaluar 237 ditë, apo afërsisht 8 muaj, nga momenti i kryerjes së veprës penale deri në nxjerrjen e aktgjykimit.




Grafika 3. Kohëzgjatja (e shprehur në ditë) prej kryerjes së veprës penale deri tek marrja e aktgjykimit në shkallë të parë

Kjo periudhë kohore është indikator i rëndësishëm për vlerësimin e efikasitetit të sistemit të drejtësisë penale në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, duke qenë se këto raste kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe mirëqenien e viktimave, kohëzgjatja e procedurës përbën element thelbësor në analizën e qasjes efektive në drejtësi.

5.1.4. Raporti familjar

Analiza e raporteve familjare ndërmjet kryerësve dhe viktimave tregon se në shumicën e rasteve, konkretisht në 33 nga 50 rastet e analizuara, kryerësi ka qenë bashkëshorti i viktimës. Kjo e dhënë konfirmon se dhuna në familje në praktikën gjyqësore shfaqet kryesisht brenda marrëdhënieve martesore apo bashkëjetesës.

Në 8 raste, dhuna është ushtruar nga prindi ndaj fëmijës, ndërsa në 8 raste të tjera nga fëmija ndaj prindit. Këto të dhëna tregojnë se fenomeni i dhunës në familje përfshin një spektër të përgjithshëm marrëdhëniesh familjare.



Grafika 4. Raporti familjar në mes të palëve³²


5.1.5. Përfaqësimi i viktimave

Në aspektin e përfaqësimit procedural, nga 50 rastet e analizuar, në 12 raste viktimat janë përfaqësuar nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave (ZMNV), çka përbën një pjesë të konsiderueshme të rasteve me përfaqësim institucional. Përveç kësaj, në 4 raste viktimat janë përfaqësuar nga avokat, ndërsa në 2 raste përfaqësimi është realizuar përmes përfaqësuesit ligjor, konkretisht prindit. Në total, kjo nënkupton se vetëm 18 nga 50 raste kanë pasur një formë të caktuar të përfaqësimit procedural.

Ndërkohë, në 26 raste, që përbëjnë shumicën e mostrës, viktimat kanë marrë pjesë në procedurë pa asnjë përfaqësues. Kjo shifër tregon një boshllëk të dukshëm në garantimin e mbështetjes juridike dhe institucionale për viktimat gjatë procesit gjyqësor.

³² Numri total i viktimave të prezantuara mund të jetë më i madh se numri i aktgjyqimeve pasi që ka raste kur në një aktgjykim janë më shumë të dëmtuar.

Po ashtu, grafika evidenton se në 3 raste viktimat nuk ka qenë e pranishme në procedurë, ndërsa në 3 raste të tjera nuk ka qenë e mundur të identifikohet statusi i përfaqësimit nga të dhënat e aktgjykimit.




Grafika 5. Përfaqësimi i viktimave të dhunës në procedurë gjyqësore

Në tërësi, struktura e përfaqësimit procedural, siç paraqitet në grafikë, dëshmon se përfshirja e mekanizmave mbrojtës dhe e përfaqësimit profesional nuk është standard i konsoliduar në praktikën gjyqësore për rastet e dhunës në familje. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e këtyre rasteve dhe pabarazinë strukturore që shpesh ekziston ndërmjet palëve, mungesa e përfaqësimit në shumicën e rasteve ngre çështje serioze lidhur me qasjen efektive në drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë procesit penal. Ky fakt është me rëndësi në kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave dhe garantimit të një procesi të drejtë, duke marrë parasysh se përfaqësimi profesional mund të ndikojë në mënyrën e paraqitjes së interesave të viktimës, kërkesave për kompensim apo masave mbrojtëse.

5.1.6. Pranimi i fajësisë

Në 46 nga 50 rastet e analizuara, të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, çka përbën një përqindje jashtëzakonisht të lartë të rasteve të përfunduara me pranimin e përgjegjësisë penale. Njëkohësisht, kjo tregon një dominim të procedurave të përmbyllura përmes deklaramit të fajësisë.



Grafika 6. Pranimi i fajësisë nga të akuzuarit

Nga perspektiva procedurale, pranimi i fajësisë zakonisht kontribuon në përshpejtimin e procesit dhe në shmangien e administrimit të provave në mënyrë të plotë, duke reduktuar kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, në praktikën e analizuar, pranimi i fajësisë është marrë sistematikisht si rrethanë lehtësuese gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjë që ka ndikuar drejtpërdrejt në politikën ndëshkimore të zbatuar në këto raste.

Një përqindje kaq e lartë e pranimit të fajësisë ngre edhe çështje të rëndësishme për analizë të mëtejme, veçanërisht në kontekstin e veprave të dhunës në familje. Në raste të tilla, pranimi formal i fajësisë nuk nënkupton domosdoshmërisht reflektim të thellë mbi sjelljen e dhunshme apo gatishmëri për ndryshim afatgjatë. Për këtë arsye, IKD konsideron se lidhja automatike ndërmjet pranimit të fajësisë dhe lehtësimit të dënimit duhet të shoqërohet me vlerësim të individualizuar të rrezikut të recidivizmit dhe nevojës për masa rehabilituese, gjë që ka munguar në aktgjykimet e analizuara nga IKD për qëllime të këtij raporti.

5.1.7. Dënimi i shqiptuar


Mostra e përgjithshme e përzgjedhur për analizë për qëllime të këtij hulumtimi ka përfshirë ekskluzivisht raste në të cilat është shqiptuar dënim me kusht. Kjo qasje metodologjike ka pasur për qëllim vlerësimin e praktikës gjyqësore pikërisht në rastet ku gjykata ka vendosur të mos zbatojë dënim efektiv me burgim, por të aplikojë masa alternative, me potencial rehabilitues dhe parandalues.

Brenda kësaj mostre prej 50 aktgjykimesh, në vetëm 10 raste të akuzuarve u është shqiptuar dënim me kusht i shoqëruar me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues, në përputhje me nenin 55 të Kodit Penal.

Kjo do të thotë se, Shërbimi Sprovues duhet të bëjë monitorim të respektimit të kushteve të caktuara dhe vlerësim të sjelljes së të dënuarit gjatë periudhës së provës, me qëllim parandalimin e përsëritjes së veprës penale dhe mbështetjen e riintegritimit social. Ndërsa, në asnjë rast nuk është shqiptuar detyrim tjetër sipas nenit 56 të Kodit penal, ku përcaktohet urdhri për të përmbushur një apo më shumë detyrime. Megjithatë, fakti që vetëm 10 nga 50 rastet me dënim me kusht janë shoqëruar me urdhër për mbikëqyrje tregon se në shumicën e rasteve dënimi me kusht është shqiptuar pa mekanizëm të strukturuar monitorimi.

5.1.8. Referimi në Konventën e Stambollit

Nga 50 rastet e analizuara, vetëm në një rast³³ gjykata në arsyetimin e aktgjykimit i është referuar Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur si Konventa e Stambollit.



Grafika 7. Referimi në Konventën e Stambollit

Kjo gjetje tregon një nivel shumë të kufizuar të referimit të drejtpërdrejtë ndaj instrumenteve ndërkombëtare në arsyetimin gjyqësor, pavarësisht rëndësisë së tyre normative dhe interpretative në fushën e mbrojtjes nga dhuna në familje.

6. Zbatimi i Programi për kryerësit e dhunës në Shërbimin Korrektues të Kosovës

Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka mandat për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe për realizimin e programeve rehabilituese dhe risocializuese për personat e privuar nga liria. Përveç garantimit të sigurisë dhe rendit në institucionet

³³ Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren me nr. P.nr.1471/21.

korrektuese, një nga funksionet e SHKK-së është përgatitja e të dënuarve për riintegrim në shoqëri përmes programeve edukative, profesionale, psikologjike dhe rehabilituese.

Në rastet e personave të dënuar për dhunë në familje dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore, roli i SHKK-së është veçanërisht i rëndësishëm, pasi perioda e vuajtjes së dënimit krijon mundësinë për ndërhyrje të strukturuar që synojnë adresimin e faktorëve që kanë ndikuar në sjelljen e dhunshme. Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave synon pikërisht ndryshimin e qëndrimeve, rritjen e përgjegjësisë individuale, zhvillimin e aftësive për komunikim jo të dhunshëm dhe parandalimin e përsëritjes së dhunës pas lirimimit.

Përfshirja e SHKK-së në zbatimin e këtij programi paraqet një element të rëndësishëm në përmbushjen e obligimeve institucionale të Kosovës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave, duke kontribuar jo vetëm në rehabilitimin e kryerësve, por edhe në rritjen e sigurisë së viktimave dhe uljen e rrezikut të recidivizmit.

Për qëllime të këtij raporti, IKD ka analizuar të dhënat e siguruar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, si dhe publikimet dhe informacionet zyrtare të institucioneve relevante lidhur me zbatimin e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave.

6.1. Zbatimi nëpër qendrat korrektuese

Nga të dhënat e siguruar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës rezulton se Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave është zbatuar ekskluzivisht vetëm në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Sipas SHKK-së, kjo ka ardhur si rezultat i numrit të kufizuar të zyrtarëve të trajnuar për zbatimin e programit, të cilët kanë qenë të sistemuar në këtë institucion korrektues.³⁴

IKD ka identifikuar se pas lansimit të programit në fund të vitit 2023, faza e parë e zbatimit praktik është konkretizuar përmes pilotimit të programit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i cili ka përfunduar në korrik të vitit 2024.³⁵

Gjetjet tregojnë se qasja fillestare e SHKK-së ka qenë e fokusuar në testimin e programit përmes pilotimit të tij në fazën fillestare. Megjithatë, fakti që programi për më shumë se dy vite është zbatuar vetëm në një qendër korrektuese ka kufizuar qasjen e personave të tjerë të dënuar për vepra të ndërlidhura me dhunën ndaj grave në këtë formë të rehabilitimit të specializuar.

³⁴ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

³⁵ Njoftim nga Ministria e Drejtësisë: <https://md.rks-gov.net/lajmet/ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave-ka-filluar-zbatimi-i-pilotimit-te-programit-kombetar-per-trajtimin-e-kryeresve-te-dhunes-ndaj-grave-lansuar-nga-ministria-e-drejtjesise/>

6.2. Personat e përfshirë

Sipas të dhënave të siguruara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, që nga lansimi i Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, gjithsej 38 persona të dënuar e kanë ndjekur ose janë aktualisht duke e ndjekur programin.³⁶

Viti	Numri i pjesëmarrësve
2024	10
2025	10
2026	18 ³⁷
Total	38

Tabela 1. Tabela me numrin e kryerësve që kanë ndjekur programin për rehabilitimin e kryerësve të dhunës me bazë gjinorë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës

Të dhënat tregojnë një rritje të numrit të pjesëmarrësve gjatë vitit 2026, çka mund të lidhet me rritjen e kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e numrit të zyrtarëve të trajnuar për zbatimin e programit.

Sipas SHKK-së, të gjithë pjesëmarrësit kanë qenë persona të dënuar për veprën penale të dhunës në familje ose për vepra të tjera penale të lidhura me dhunën me bazë gjinore.³⁸ Në mesin e tyre përfshihen persona të dënuar për vepra si lëndimi trupor, sulmi dhe shantazhi, kur këto vepra kanë qenë të ndërlidhura me kontekstin e dhunës në familje.³⁹ Ndërkaq, asnjë person i dënuar me burgim të përjetshëm nuk ka qenë pjesë e programit.⁴⁰

6.3. Mënyra e përfshirjes së të dënuarve

Programi realizohet përmes cikleve gjashtëmujore të trajtimit dhe përbëhet nga dhjetë module dhe gjithsej njëzet e katër sesione, të cilat zhvillohen një herë në javë. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti janë realizuar tre cikle të plota të trajtimit, ndërsa një cikël tjetër është në proces.⁴¹

Përfshirja e personave të dënuar në program bazohet në gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë. Sipas SHKK-së, identifikimi i kandidatëve potencialë realizohet në kuadër të procesit të planifikimit individual të ekzekutimit të dënimit, i cili zhvillohet nga Njësia për Vlerësim dhe

³⁶ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

³⁷ Tetë pjesëmarrës në grupin e parë dhe dhjetë pjesëmarrës në grupin e dytë.

³⁸ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ Po aty.

Klasifikim të Burgosurve. Në këtë proces vlerësohen nevojat rehabilituese, faktorët e rrezikut dhe programet që konsiderohen të përshtatshme për secilin të dënuar.⁴²

6.4. Mënyra e realizimit

Sipas të dhënave të siguruar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, realizimi i Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave paraprihet nga intervista motivuese të zhvilluara nga zyrtarët përgjegjës për programet rehabilituese. Përmes këtyre intervistave vlerësohet gatishmëria e personave të dënuar për të marrë pjesë në program dhe për të përfituar nga procesi i trajtimit.⁴³

Pas përzgjedhjes së pjesëmarrësve, bëhen përgatitjet organizative dhe logjistike për zhvillimin e sesioneve, përfshirë koordinimin ndërmjet zyrtarëve përgjegjës dhe sigurimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e programit. Programi mbahet një herë në javë, ndërsa organizimi i hapësirës synon të krijojë një mjedis sa më gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit, me qëllim të lehtësimit të komunikimit, ndërveprimit dhe pjesëmarrjes aktive të secilit anëtar të grupit.⁴⁴ Në fillim të programit vendosen rregullat bazë të funksionimit të grupit, të cilat diskutohen dhe miratohen nga pjesëmarrësit. Nënshkrimi i këtyre rregullave shërben si një formë zotimi për respektimin e procesit dhe krijimin e një ambienti të sigurt për diskutim dhe reflektim.⁴⁵

6.5. Trajnimi i zyrtarëve

Kapacitetet profesionale të stafit paraqesin një element kyç për zbatimin efektiv të Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave. Sipas të dhënave të siguruar nga SHKK, gjatë periudhës së zbatimit të programit janë ndërmarrë disa aktivitete me qëllim ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përgjegjës për realizimin e tij.

Një zhvillim i rëndësishëm është certifikimi i 16 zyrtarëve për programe dhe çështje sociale më 26 maj 2026, të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimin për zbatimin e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave. Me këtë rast, numri total i zyrtarëve të certifikuar në këtë institucion ka arritur në 17.⁴⁶ Sipas SHKK-së, ky zhvillim krijon kushtet për zgjerimin e programit edhe në institucionet e tjera korrektuese,⁴⁷ duke tejkaluar kufizimin e mëparshëm që kishte bërë të mundur zbatimin e programit vetëm në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Përveç trajnimeve të specializuara për zbatuesit e programit, zyrtarët e certifikuar kanë organizuar trajnime të brendshme për personelin korrektues lidhur me trajtimin e kryerësve të dhunës ndaj

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Po aty.

⁴⁶ Input nga përfaqësues të SHKK në takimin konsultativ të organizuar nga IKD, në Prishtinë, më 12.06.2026

⁴⁷ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

grave dhe dhunës në familje. Sipas të dhënave të pranuar, gjatë viteve 2024, 2025 dhe tremujorit të parë të vitit 2026, në këto aktivitete trajnuese kanë marrë pjesë rreth 300 zyrtarë.⁴⁸

Këto tregojnë se ngritja e kapaciteteve profesionale ka qenë një nga investimet kryesore institucionale në funksionalizimin e programit. Megjithatë, IKD konsideron se fakti që programi është zbatuar vetëm në një institucion korrektues deri në vitin 2026 tregon se procesi i ndërtimit të kapaciteteve ka qenë gradual dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në shtrirjen e kufizuar të programit gjatë fazave fillestare të implementimit.

6.6. Sfidat e identifikuara

Sipas Shërbimit Korrektues të Kosovës, një nga sfidat kryesore gjatë fazës fillestare të zbatimit të Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave ka qenë numri i kufizuar i zyrtarëve të certifikuar për realizimin e tij.⁴⁹ Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë e zbatimit të programit vetëm në një institucion korrektues. Megjithatë, pas certifikimit të 16 zyrtarëve të rinj gjatë vitit 2026, me ç'rast ka shkuar në tërësi numri në gjithsej 17 zyrtarë të certifikuar, kjo pritet të mundësojë zgjerimin gradual të programit në institucionet e tjera korrektuese.

Përtej kapaciteteve institucionale, SHKK identifikon një sërë sfidash që lidhen me vetë pjesëmarrësit në program. Këto përfshijnë rezistencën ndaj ndryshimit, normalizimin e sjelljeve të dhunshme, minimizimin e pasojave të dhunës, mungesën e vetëdijes për përgjegjësinë personale, si dhe hezitimin e disa pjesëmarrësve për të diskutuar hapur për përvojat dhe sjelljet e tyre.⁵⁰

Nga perspektiva e rehabilitimit, IKD vlerëson se këto sfida paraqesin pengesa të zakonshme në trajtimin e kryerësve të dhunës, pasi shumë prej tyre nuk e pranojnë plotësisht përgjegjësinë për veprimet e tyre ose tentojnë të justifikojnë sjelljet e dhunshme. Për këtë arsye, efektiviteti i programeve të tilla krahas cilësisë së përmbajtjes së tyre, varet edhe nga aftësia e profesionistëve për të ndërtuar motivim dhe reflektim tek pjesëmarrësit.

6.7. Vlerësimet pozitive

Sipas vlerësimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave ka prodhuar rezultate pozitive tek pjesëmarrësit që kanë përfunduar ose janë duke ndjekur trajtimin.⁵¹ Vlerësimet e institucionit tregojnë se programi ka ndikuar në rritjen e vetëdijesimit të pjesëmarrësve lidhur me natyrën dhe pasojat e dhunës, në promovimin e marrjes së përgjegjësisë për sjelljet e tyre, si dhe në zhvillimin e formave më të shëndetshme të komunikimit dhe menaxhimit të konflikteve.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Po aty.

Sipas SHKK-së, pjesëmarrësit kanë shfaqur reflektim më të madh mbi ndikimin që dhuna ka tek partneret, fëmijët dhe anëtarët e tjerë të familjes. Në një numër rastesh, të dënuarit kanë shprehur gatishmëri për të pranuar përgjegjësinë për sjelljet e tyre dhe për të ndërmarrë hapa drejt ndryshimit personal.⁵² Gjithashtu, sipas informacioneve të siguruara, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar programin pozitivisht dhe kanë raportuar se përmbajtja e trajtimit ka ndikuar në mënyrën se si ata e kuptojnë dhunën, marrëdhëniet ndërpersonale dhe pasojat e veprimeve të tyre. Në disa raste, pjesëmarrësit kanë shprehur gatishmëri që përvojat e tyre me programin t'i ndajnë publikisht, duke kërkuar falje ndaj familjeve të tyre dhe duke reflektuar mbi dëmet e shkaktuara nga sjelljet e mëhershme.

Megjithatë, IKD gjen se këto vlerësime bazohen kryesisht në perceptimet e institucionit dhe të pjesëmarrësve në program. Në këtë drejtim, IKD vlerëson se efektiviteti i programit nuk duhet të matet vetëm përmes progresit të raportuar nga kryerësit apo institucionet zbatuese, por edhe përmes ndikimit konkret që ai ka në rritjen e sigurisë së viktimave, pasi qëllimi përfundimtar i programeve për kryerësit e dhunës nuk është vetëm rehabilitimi i tyre, por parandalimi i përsëritjes së dhunës dhe mbrojtja e viktimave. Për këtë arsye, monitorimi dhe vlerësimi i programit duhet të përfshijë, aty ku është e mundur dhe e sigurt, edhe perspektivën e viktimave lidhur me ndryshimet e vërejtura në sjelljen e kryerësit dhe nivelin e sigurisë së tyre pas përfundimit të trajtimit.

7. Zbatimi i Programi për kryerësit e dhunës në Shërbimin Sprovues të Kosovës

Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) ka rol të rëndësishëm në rehabilitimin dhe riintegrimin e personave ndaj të cilëve janë shqiptuar masa dhe dënime alternative, si dhe në mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht. Përmes mbikëqyrjes në komunitet dhe menaxhimit individual të rasteve, SHSK ka mundësi të veçantë për të adresuar faktorët e rrezikut që lidhen me përsëritjen e veprave penale, përfshirë rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Përfshirja e Shërbimit Sprovues në Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e kryerësve të dhunës mbikëqyren në komunitet dhe jo në institucione korrektuese. Për këtë arsye, funksionalizimi i programit në kuadër të SHSK-së do të mundësonte qasje më të hershme dhe më të gjerë ndaj ndërhyrjeve rehabilituese, duke kontribuar në parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe rritjen e sigurisë së viktimave.

7.1. Zbatimi në Shërbimin Sprovues

Sipas të dhënave të siguruara nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave ende nuk ka filluar të zbatohet në praktikë në kuadër të këtij institucioni.⁵³

⁵² Po aty.

⁵³ Përgjigjet e SHSK për IKD, 01.06.2026.

SHSK ka bërë të ditur se, sipas planifikimit fillestar institucional, programi është paraparë të pilotohet dhe konsolidohet fillimisht në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përpara se të zgjerohet edhe në Shërbimin Sprovues. Për rrjedhojë, deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk ka pasur persona të përfshirë në program në kuadër të mbikëqyrjes sprovuese.

Kështu megjithëse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga lansimi i Programit Kombëtar, personat që mbikëqyren nga Shërbimi Sprovues ende nuk kanë pasur qasje në këtë mekanizëm të specializuar rehabilitimi. IKD vlerëson se kjo krijon një boshllëk në ofrimin e ndërhyrjeve për kryerësit e dhunës që ndodhen në komunitet, duke kufizuar shtrirjen e programit vetëm tek personat e privuar nga liria. Ky boshllëk bëhet edhe më i theksuar kur analizohet në raport me praktikën gjyqësore. Siç është evidentuar në këtë raport, në asnjërin prej 50 aktgjykimeve të analizuara, gjykatat nuk kanë shqiptuar ndonjë nga detyrimet e parapara në nenin 56 të Kodit Penal, përfshirë detyrimin për nënshtrim në programe trajtimi apo rehabilitimi. Për rrjedhojë, mekanizmi ligjor që do të mundësonte referimin e detyrueshëm të kryerësve në Programin Kombëtar nuk është aktivizuar në praktikë.

Në këtë kontekst, mungesa e zbatimit të programit në Shërbimin Sprovues dhe mungesa e referimeve të detyrueshme nga gjykatat paraqesin dy elemente të ndërlidhura që kufizojnë ndjeshëm efektivitetin dhe shtrirjen e Programit, duke bërë kështu që një pjesë e konsiderueshme e kryerësve të mbeten jashtë çdo forme të trajtimit të specializuar.

Megjithëse programi ende nuk zbatohet në praktikë në kuadër të Shërbimit Sprovues, sipas të dhënave të siguruara nga ky institucion, aktivitetet aktuale kufizohen në informimin e personave nën mbikëqyrje për ekzistencën dhe rëndësinë e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave.⁵⁴ Për rrjedhojë, ndërhyrja institucionale në këtë fazë mbetet kryesisht në nivel informues, pa mundur përfshirjen e kryerësve në trajtimin e strukturuar dhe të specializuar të paraparë me program.

Ndërsa për rastet me kohëzgjatje më të madhe të masave ose dënimeve alternative, zyrtarët sprovues, në cilësinë e menaxherëve të rasteve, adresojnë individualisht elemente të ngjashme me ato të programit gjatë takimeve të rregullta të mbikëqyrjes.⁵⁵ Këto ndërhyrje përfshijnë diskutime mbi përgjegjësinë individuale, pasojat e dhunës dhe rëndësinë e ndryshimit të sjelljeve.

Megjithatë, këto aktivitete nuk përbëjnë zbatim formal të Programit dhe nuk zhvillohen sipas strukturës, moduleve dhe metodologjisë së paraparë në program. Për rrjedhojë, personat e mbikëqyrrur nga SHSK nuk përfitojnë aktualisht nga trajtimi i plotë dhe i standardizuar që ofron programi.

⁵⁴ Po aty.

⁵⁵ Po aty.

7.2. Trajnimi i zyrtarëve

Sipas të dhënave të siguruara nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, 3 zyrtarë të këtij institucioni janë certifikuar si trajnerë për zbatimin e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave nga Ministria e Drejtësisë.⁵⁶

Përveç tyre, njëmbëdhjetë zyrtarë të tjerë kanë ndjekur trajnime të specializuara lidhur me programin përgjatë viteve 2022 dhe 2023.⁵⁷ Këto trajnime kanë synuar ngritjen e kapaciteteve profesionale për trajtimin e kryerësve të dhunës dhe përgatitjen e stafit për zbatimin e programit në kuadër të mbikëqyrjes sprovuese.

IKD gjen se Shërbimi Sprovues ka ndërmarrë disa hapa në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe ka krijuar një bazë fillestare të ekspertizës së nevojshme për zbatimin e programit. Megjithatë, programi ende nuk është operacionalizuar, duke krijuar një mospërputhje ndërmjet kapaciteteve të ndërtuara dhe ofrimit faktik të shërbimeve.

7.3. Sfidat e identifikuara

Sipas Shërbimit Sprovues të Kosovës, një nga sfidat kryesore për zbatimin e Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave lidhet me formimin e grupeve të pjesëmarrësve.⁵⁸ Ndryshe nga institucionet korrektuese, ku pjesëmarrësit ndodhen në të njëjtin institucion, SHSK mbikëqyr persona që jetojnë në komunitet dhe që kanë obligime të ndryshme familjare, profesionale dhe sociale. Për rrjedhojë, organizimi i grupeve të rregullta të trajtimit paraqet sfidë të konsiderueshme praktike dhe logjistike.

Një tjetër sfidë lidhet me natyrën vullnetare të pjesëmarrjes në program.⁵⁹ Sipas SHSK-së, mungesa e një obligimi formal për ndjekjen e programit mund të ndikojë në motivimin e personave për t'u përfshirë dhe për të vazhduar pjesëmarrjen në mënyrë të rregullt dhe kjo sfidë bëhet edhe më e theksuar në rastet kur personat e mbikëqyrur nuk e pranojnë përgjegjësinë për sjelljet e tyre ose nuk e konsiderojnë të nevojshëm trajtimin.⁶⁰

Po ashtu, kufizimet buxhetore dhe burimet e kufizuara financiare vazhdojnë të paraqesin pengesa në zhvillimin e programeve të specializuara rehabilituese dhe në sigurimin e mbështetjes së nevojshme profesionale për zbatimin e tyre.⁶¹

Nga perspektiva e mbrojtjes së viktimave, IKD vlerëson se mosfunksionalizimi i Programit Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave në nivel të Shërbimit Sprovues paraqet një sfidë të veçantë. Kjo për faktin se një pjesë e konsiderueshme e kryerësve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje mbeten në komunitet dhe vazhdojnë të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë ose të tërthortë

⁵⁶ Po aty.

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty.

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Po aty.

me viktimat. Për më tepër, gjetjet e këtij raporti dhe raporteve të tjera të IKD-së, tregojnë se në praktikën gjyqësore të Kosovës, numri më i madh i dënimeve të shqiptuara për rastet e dhunës në familje janë dënime me kusht. Në këtë kontekst, fakti që Programi aktualisht zbatohet vetëm në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës nënkupton se pjesa dërrmuese e personave të dënuar për dhunë në familje dhe forma të tjera të dhunës ndaj grave nuk i nënshtrohen këtij programi rehabilitues. Si rezultat, mundësitë për adresimin e faktorëve që lidhen me sjelljen e dhunshme, marrjen e përgjegjësisë dhe parandalimin e përsëritjes së dhunës mbeten të kufizuara pikërisht tek grupi më i madh i kryerësve.

IKD vlerëson se vonesa në operacionalizimin e programit në Shërbimin Sprovues kufizon mundësitë për ndërhyrje të hershme rehabilituese dhe për menaxhimin e rrezikut të recidivizmit. Njëkohësisht, kjo situatë për IKD-në ngre shqetësime edhe nga perspektiva e sigurisë së viktimave, pasi shumica e kryerësve që mbeten në komunitet nuk kanë qasje në një program të strukturuar dhe të specializuar që synon ndryshimin e sjelljeve të dhunshme.

8. Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Programit

Monitorimi, mbledhja e të dhënave dhe raportimi i rregullt mbi Programin për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave përbëjnë elemente thelbësore për vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve institucionale në parandalimin e përsëritjes së dhunës dhe mbrojtjen e viktimave. Përmes sistemeve të raportimit dhe bazave të të dhënave, institucionet përgjegjëse mund të identifikojnë numrin e personave të përfshirë në program, shkallën e përfundimit të tij, sfidat në zbatim dhe rezultatet e arritura.

Nga perspektiva e mbrojtjes së viktimave, IKD vlerëson se monitorimi dhe vlerësimi i Programit nuk duhet të kufizohen vetëm në të dhënat statistikore mbi numrin e pjesëmarrësve, shkallën e përfundimit të programit apo aktivitetet e realizuara. Vlerësimi i efektivitetit të Programit duhet të mundësojë matjen e ndikimit të tij në ndryshimin e sjelljes së kryerësve, rritjen e përgjegjësisë për veprimet e tyre, uljen e rrezikut të përsëritjes së dhunës dhe forcimin e sigurisë së viktimave. Për këtë arsye, IKD vlerëson se mbledhja sistematike e të dhënave dhe raportimi periodik janë komponentë të domosdoshëm të një qasjeje të bazuar në evidencë dhe të përqendruar te viktima.

Gjithashtu, IKD rekomandon që, aty ku është e mundur dhe pa cenuar sigurinë, privatësinë dhe mirëqenien e viktimave, procesi i monitorimit dhe vlerësimit të përfshijë edhe perspektivën e tyre. Duke qenë se qëllimi përfundimtar i Programit është mbrojtja e viktimave dhe parandalimi i përsëritjes së dhunës, perceptimet dhe përvojat e tyre përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimit të tij. Kjo çështje duket të jetë sfiduese në monitorimin e zbatimit të programeve në vende të ndryshme të botës, nga ku rezulton se nga 23 shtete të përfshira me 48 programe, vetëm 42.85% e programeve të shqyrtuara raportuan se përfshijnë reagimet dhe vlerësimet e viktimave në procesin e matjes së rezultateve.⁶² Për të

⁶² Këshilli i Evropës, “Udhëzues për programe të sigurta dhe efektive për kryerësit e dhunës sipas Nenit 16 të Konventës së Stambollit: Studim krahasues dhe rekomandime për programet e kryerësve të dhunës në familje dhe

realizuar një vlerësim efektiv mbi këtë bazë, është thelbësore që të përdoren të dhëna nga burime të ndryshme, përfshirë edhe dëshmitë dhe përvojat e viktimave. Monitorimi i vazhdueshëm i progresit gjatë gjithë kohëzgjatjes së programit, krahasimi i të dhënave të mbledhura para fillimit të programit dhe pas përfundimit të tij, si dhe përdorimi i instrumenteve të standardizuara të vlerësimit, përbëjnë elemente kyçe të një sistemi efektiv të monitorimit dhe vlerësimit.⁶³

Praktika e sistemit në Skoci ilustron rëndësinë e investimit në kapacitetet profesionale dhe në standardizimin e proceseve të monitorimit dhe vlerësimit të programeve për kryerësit e dhunës, duke u mbështetur në procedura të standardizuara për mbledhjen e të dhënave në nivel kombëtar, duke siguruar që informacioni të mblidhet në mënyrë të njëtrajtshme dhe të krahasueshme në të gjitha institucionet zbatuese.⁶⁴ Një nga elementet kyçe të këtij modeli është trajnimi i vazhdueshëm i profesionistëve jo vetëm për zbatimin e programit, por edhe për metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të punës së tyre.⁶⁵ Kjo qasje kontribuon në rritjen e cilësisë së raportimit, në sigurimin e të dhënave më të besueshme dhe në krijimin e një kulture institucionale të bazuar në evidencë dhe llogaridhënie. Po ashtu, koordinimi i procesit nga një ekspert i dedikuar për monitorim dhe vlerësim, si dhe angazhimi periodik i vlerësuesve të jashtëm të pavarur, paraqesin mekanizma të rëndësishëm për garantimin e objektivitetit, identifikimin e mangësive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit.⁶⁶

IKD konsideron se kjo përvojë tregon se efektiviteti i programeve për kryerësit e dhunës është i lidhur ngushtë me ekzistimin e procedurave të qarta të monitorimit, trajnimin adekuat të zyrtarëve përgjegjës dhe respektimin e standardeve të unifikuara të zbatimit dhe raportimit.

Rëndësia e raportimit dhe e mbajtjes së evidencave është njohur edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026. Në kuadër të Objektivës Strategjike 1, “Parandalimi dhe identifikimi i dhunës”, strategjia ka paraparë krijimin dhe zbatimin e programeve për trajtimin psiko-social të kryerësve të veprave penale të dhunës.⁶⁷ Për të siguruar monitorimin e këtyre programeve, Plani i Veprimit ka paraparë dy masa të rëndësishme: krijimin e një baze të të dhënave për kryerësit që kanë marrë shërbime apo trajtim psiko-social gjatë dhe pas kryerjes së dënimit, si dhe përgatitjen e raporteve vjetore mbi rehabilitimin e kryerësve të dhunës.⁶⁸

Për qëllime të këtij raporti, IKD i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me kërkesë për informata lidhur me zbatimin e këtyre aktiviteteve strategjike,⁶⁹ përkatësisht nëse është krijuar baza e të dhënave e paraparë me Strategjinë Kombëtare, mënyrën e funksionimit të saj, numrin e personave

dhunës seksuale”, 2024. (<https://rm.coe.int/guidance-for-safe-and-effective-perpetrator-programmes-article-16-of-t/1680b00524>).

⁶³ Po aty.

⁶⁴ Po aty, fq. 17.

⁶⁵ Po aty.

⁶⁶ Po aty.

⁶⁷ Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026, fq. 39.

⁶⁸ Po aty, fq. 76-77.

⁶⁹ Kërkesë për informata dhe qasje në dokumente publike nga IKD drejtuar MD, 05.06.2026.

të regjistruar si përfitues të trajtimit psiko-social gjatë dhe pas kryerjes së dënimit, si dhe kemi kërkuar qasje në raportet vjetore mbi rehabilitimin e kryerësve të dhunës për vitet 2024 dhe 2025.

Sa i përket krijimit të bazës së të dhënave për kryerësit që kanë marrë shërbime apo trajtim psiko-social gjatë dhe pas ekzekutimit të dënimit, Ministria e Drejtësisë në përgjigjen për IKD, ka theksuar se menaxhon Databazën Nacionale për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje (DBN), një sistem ndërinstucional i krijuar për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave që lidhen me rastet e dhunës në familje. Sipas MD-së, në kuadër të kësaj databaze regjistrohen edhe të dhëna mbi shërbimet dhe trajtimet psiko-sociale të ofruara për kryerësit e dhunës në familje, varësisht nga institucionet përgjegjëse për ofrimin e tyre.⁷⁰ Në mbështetje të këtij qëndrimi, MD ka referuar edhe linkun e Databazës Nacionale për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje.⁷¹

Megjithatë, IKD vlerëson se kjo përgjigje nuk dëshmon përmbushjen e obligimit për krijimin e një baze të veçantë të të dhënave për kryerësit që kanë marrë shërbime apo trajtim psiko-social gjatë dhe pas ekzekutimit të dënimit, siç parashihet në dokumentet strategjike të miratuara nga vetë MD.

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se DBN përmban të dhëna mbi rastet e raportuara, viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë, ndër të tjera, numrin e viktimave të vrara, rastet e dhunës seksuale të raportuara brenda familjes, urdhrat për mbrojtje emergjente, numrin e grave dhe fëmijëve të strehuar, si dhe kategorizimin e viktimave dhe kryerësve sipas gjinisë, moshës dhe nacionalitetit. Për më tepër, rastet e evidentuara në DBN nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht persona që, për shkak të statusit të tyre penal, janë referuar ose kanë qenë të obliguar të ndjekin Programin. Kjo për arsye se DBN evidenton të gjitha rastet e raportuara të dhunës në familje dhe të gjithë kryerësit e identifikuar në këto raste, pavarësisht nëse ata janë referuar, kanë ndjekur apo janë duke ndjekur Programin.

Përkundër se DBN përmban informacione bazike për kryerësit, ajo nuk është konceptuar si mekanizëm i dedikuar për monitorimin e zbatimit dhe rezultateve të Programit për trajtimin e kryerësve. Nga informacionet e siguruar nga IKD gjatë intervistave me përfaqësues institucionalë rezulton se në DBN evidentohen të dhëna lidhur me fillimin dhe përfundimin e pjesëmarrjes së kryerësit në Program. Megjithatë, DBN nuk mundëson evidentimin dhe analizimin e të dhënave më të detajuara që do të lejonin monitorimin efektiv të progresit dhe rezultateve të Programit.

IKD vlerëson se një bazë e të dhënave e dedikuar për kryerësit që ndjekin Programin duhet të përmbajë informacione të detajuara dhe të standardizuara lidhur me pjesëmarrjen dhe progresin e tyre. Kjo duhet të përfshijë, ndër të tjera, mënyrën e referimit në Program, statusin e pjesëmarrjes së tyre, përfundimin ose ndërprerjen e Programit dhe arsyet përkatëse, plotësimin e instrumenteve të monitorimit dhe vlerësimit, rezultatet e vlerësimeve periodike, si dhe të dhëna të tjera relevante që mundësojnë matjen e efektivitetit të Programit dhe identifikimin e sfidave në zbatimin e tij.

⁷⁰ Përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë/Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në kërkesën për informata të IKD-së, 16.06.2026.

⁷¹ Linku si reference nga MD në përgjigjen për IKD: <https://md.rks-gov.net/publikimet/statistikat/>.

Ministria e Drejtësisë së Kosovës, me mbështetjen e projektit të Këshillit të Evropës “Përafrimi i ligjeve dhe politikave me Konventën e Stambollit”.⁷⁶

Me këtë rast IKD ka evidentuar një sërë çështjesh që lidhen me cilësinë e të dhënave, konsistencën e raportimit dhe metodologjinë e përdorur për vlerësimin e Programit.

8.1.1. Raporti për vitin 2024

Analiza e raportit të vlerësimit të Programit për vitin 2024 ka evidentuar fillimisht mospërputhje të konsiderueshme lidhur me numrin e pjesëmarrësve në Program. Sipas informatave të marra gjatë intervistave me institucionet përgjegjëse, gjatë vitit 2024 në Program kanë marrë pjesë 10 persona.⁷⁷ Ndërkohë, nga të dhënat e dorëzuara nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të kërkesës për qasje në dokumente publike të IKD-së, në rubrikën e emërtuar “Programi i dhunës në familje” figurojnë 13 pjesëmarrës.⁷⁸ Në anën tjetër, raporti i vlerësimit të Programit thekson se pilot-programi i realizuar në Burgun e Dubravës ka përfshirë gjithsej 20 kryerës të veprave të dhunës ndaj grave.⁷⁹ Më tej, raporti sqaron se vetëm 18 prej tyre janë përfshirë në procesin e vlerësimit, pasi të tjerët janë liruar nga vuajtja e dënimit para përfundimit dhe, rrjedhimisht, nuk kanë plotësuar pyetësorët e monitorimit.⁸⁰ Megjithatë, në pjesën ku paraqiten karakteristikat socio-demografike të pjesëmarrësve, të dhënat janë prezantuar vetëm për tetë persona.⁸¹ Këto mospërputhje nuk janë sqaruar si duhet në raport dhe krijojnë paqartësi serioze lidhur me numrin real të pjesëmarrësve në Program, numrin e personave të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe bazën e të dhënave mbi të cilën janë nxjerrë përfundimet e raportit.

Raporti evidenton se përbërja e grupit ka ndryshuar gjatë zbatimit të Programit.⁸² Sipas raportit, nuk ka qenë e mundur të maten ndryshimet individuale gjatë kohës dhe se analiza është bazuar në të dhëna të grumbulluara në nivel grupi.⁸³ Po ashtu, raporti thekson se përfundimet duhet të interpretohen me kujdes për shkak të madhësisë së vogël të mostrës dhe ndryshimeve në përbërjen e grupit, si dhe se rezultatet nuk mund të përgjithësohen për pjesëmarrës të tjerë apo programe të ngjashme.⁸⁴

Pavarësisht këtyre kufizimeve, raporti paraqet disa rezultate pozitive lidhur me reduktimin e sjelljeve abuzive,⁸⁵ rritjen e përgjegjësisë së kryerësve⁸⁶ dhe vetëdijësimin e tyre për ndikimin e

⁷⁶ Raporti i IMPACT, Analiza e të dhënave të mbledhura nga Instrumenti i Monitorimit të Rezultateve IMPACT përshtatur me kontekstin e burgut, 2024, fq. 2 dhe 4.

⁷⁷ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

⁷⁸ Përgjigja e MD në kërkesën për qasje në dokumente publike të IKD, 17.06.2026.

⁷⁹ Raporti, fq. 4.

⁸⁰ Po aty, fq. 4-5.

⁸¹ Po aty, fq. 17.

⁸² Po aty, fq. 13.

⁸³ Po aty.

⁸⁴ Po aty.

⁸⁵ Po aty, fq. 6.

⁸⁶ Po aty, fq. 7.

dhunës ndaj viktimave.⁸⁷ Megjithatë, vetë raporti pranon se forma të caktuara të kontrollit, xhelozisë, posesivitetit dhe stereotipeve gjinore kanë vazhduar të jenë të pranishme edhe në përfundim të Programit, ndërsa një nivel i konsiderueshëm i fajësimit të viktimave ka mbetur ende prezent tek një pjesë e pjesëmarrësve.⁸⁸

Një çështje tjetër me rëndësi ka të bëjë me procesin e mbledhjes së të dhënave nga viktimat. Raporti thekson se nuk ka qenë e mundur të mblidhen të dhëna drejtpërdrejt nga viktimat për shkak të mungesës së shërbimeve të specializuara të mbështetjes, mungesës së qasjes së tyre në këshillim apo mbështetje psiko-sociale dhe rrethanave që mund të paraqisnin rrezik për sigurinë e tyre.⁸⁹ Për këtë arsye, procesi i mbledhjes së pyetësorëve nga viktimat është ndërprerë dhe, si alternativë, janë përdorur vlerësimet e pesë lehtësuesve të Programit, të cilët kanë plotësuar pyetësorë për secilin pjesëmarrës bazuar në perceptimet dhe vlerësimet e tyre profesionale.⁹⁰

Ndonëse raporti e konsideron këtë qasje si zgjidhje alternative, vetë gjetjet e raportit tregojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet perceptimeve të kryerësve dhe vlerësimeve të lehtësuesve. Për shembull, në fund të Programit shumica e kryerësve kanë deklaruar se (ish) partneret e tyre pothuajse nuk kishin më frikë prej tyre, ndërsa lehtësuesit kanë vlerësuar se rreth dy të tretat e viktimave mund të vazhdojnë të kenë frikë nga kryerësi.⁹¹ Mospërputhje të ngjashme janë evidentuar edhe sa i përket ndikimit të Programit në aftësitë prindërore dhe marrëdhëniet me fëmijët.⁹² Këto dallime tregojnë rëndësinë e përfshirjes së perspektivës së viktimave në procesin e monitorimit dhe vlerësimit, pasi mbështetja ekskluzive në vetëvlerësimin e kryerësve nuk mund të ofrojë një pasqyrë të plotë mbi rezultatet reale të Programit. Në mungesë të perspektivës së viktimave, ekziston rreziku që rezultatet e Programit të paraqiten më pozitive sesa ndikimi real që ato kanë në sigurinë dhe mirëqenien e viktimave.

Po ashtu, raporti identifikon mangësi edhe në vetë procesin e vlerësimit nga lehtësuesit.⁹³ Në seksionin e vëzhgimeve të lehtësuesve evidentohet se ka pasur vlerësime jo konsistente ndërmjet tyre, perceptime të ndryshme për nivelin e rrezikut të pjesëmarrësve, si dhe dallime që lidhen me nivelin e përfshirjes së tyre në zbatimin e Programit dhe përvojën profesionale. Vetë raporti rekomandon standardizimin e procedurave të vlerësimit, zhvillimin e protokolleve të përbashkëta për vlerësimin e rrezikut, mbajtjen e takimeve të rregullta për shqyrtimin e rasteve dhe trajnimin e vazhdueshëm të stafit. Këto gjetje tregojnë se edhe mekanizmat e brendshëm të monitorimit dhe vlerësimit kanë nevojë për përmirësim në mënyrë që të sigurohet konsistencë dhe besueshmëri më e madhe e të dhënave.

Në aspekt të përgjithshëm, IKD vlerëson se raporti i vlerësimit përbën një hap të rëndësishëm drejt monitorimit të rezultateve të Programit, mirëpo mospërputhjet në raportimin e të dhënave bazë,

⁸⁷ Po aty, fq. 8-9.

⁸⁸ Po aty, fq. 6-10.

⁸⁹ Po aty, fq. 5.

⁹⁰ Po aty.

⁹¹ Po aty, fq. 7 dhe 9.

⁹² Po aty, fq. 9-10.

⁹³ Po aty, fq. 33-34.

mungesa e informacionit të drejtpërdrejtë nga viktimat, kufizimet metodologjike të pranuar nga vetë autorët e raportit dhe mungesa e një sistemi të strukturuar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të të dhënave kufizojnë mundësinë për të nxjerrë përfundime të plota dhe të besueshme mbi efektivitetin afatgjatë të Programit. Këto gjetje nënvizojnë nevojën për forcimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, standardizimin e metodologjisë së mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, si dhe sigurimin e mekanizmave që mundësojnë përfshirjen e perspektivës së viktimave në vlerësimin e rezultateve të Programit.

8.1.2. Raporti për vitin 2025

Analiza e raportit të vlerësimit të Programit për vitin 2025 gjithashtu evidenton mospërputhje lidhur me numrin e pjesëmarrësve dhe mungesën e një sistemi të unifikuar raportimi. Sipas raportit të vlerësimit, Programi i zbatuar në Burgun e Dubravës gjatë periudhës shkurt-korrik 2025 ka përfshirë gjithsej 15 persona të dënuar, të cilët kanë marrë pjesë në Program dhe në procesin e hulumtimit në periudha të ndryshme kohore.⁹⁴ Megjithatë, të dhënat e siguruar nga IKD përmes institucioneve përgjegjëse evidentojnë 10 pjesëmarrës gjatë vitit 2025.⁹⁵ Në anën tjetër, të dhënat nga Ministria e Drejtësisë evidentojnë 12 pjesëmarrës në Programin për trajtimin e kryerësve të dhunës në familje gjatë vitit 2025.⁹⁶ Po ashtu, nga të dhënat e njëjta rezulton se në periudhën nëntor 2025-prill 2026 janë përfshirë edhe 19 pjesëmarrës të tjerë,⁹⁷ ndërsa nga marsi 2026 e tutje figurojnë edhe 12 pjesëmarrës shtesë.⁹⁸ Ndërkohë, të dhënat e siguruar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës evidentojnë dy grupe të ndara pjesëmarrësish gjatë vitit 2026, me gjithsej 18 persona, përkatësisht një grup prej 8 dhe një grup prej 10 pjesëmarrësish.⁹⁹

Ashtu si në raportin për vitin 2024, edhe në këtë rast mospërputhjet ndërmjet burimeve të ndryshme të të dhënave e vështirësojnë identifikimin e numrit real të pjesëmarrësve në Program dhe krijojnë paqartësi lidhur me bazën faktike mbi të cilën mbështetet monitorimi dhe raportimi institucional. Kjo situatë nënvizon edhe një herë nevojën për krijimin e një sistemi të centralizuar dhe të standardizuar të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave për pjesëmarrësit në Program.

Raporti po ashtu evidenton se pjesëmarrësit janë përfshirë në Program në periudha të ndryshme kohore dhe se përbërja e grupit ka ndryshuar gjatë zbatimit të tij. Disa persona janë përfshirë në Program pas fillimit të procesit, ndërsa të tjerë e kanë ndërprerë pjesëmarrjen për shkak të lirimit nga burgu.¹⁰⁰ Sipas vetë raportit, këto ndryshime, së bashku me madhësinë e vogël të mostrës, kanë paraqitur sfida për analizimin e ndryshimeve individuale gjatë kohës dhe kanë kufizuar

⁹⁴ Raporti i IMPACT, Analiza e të dhënave të mbledhura nga Instrumenti i Monitorimit të Rezultateve IMPACT – Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues, Burgu i Dubravës, 2026, fq. 4.

⁹⁵ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

⁹⁶ Përgjigja e MD në kërkesën për qasje në dokumente publike të IKD, 17.06.2026.

⁹⁷ Po aty.

⁹⁸ Po aty.

⁹⁹ Përgjigjet e SHKK për IKD, 03.06.2026.

¹⁰⁰ Raporti i IMPACT, Analiza e të dhënave të mbledhura nga Instrumenti i Monitorimit të Rezultateve IMPACT – Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Korrektues, Burgu i Dubravës, 2026, fq. 5.

mundësinë e nxjerrjes së përfundimeve të përgjithshme mbi efektivitetin e Programit. Për këtë arsye, raporti rekomandon që gjetjet të interpretohen me kujdes.¹⁰¹

Një çështje që mbetet e pandryshuar edhe në raportin për vitin 2025 është mungesa e perspektivës së viktimave në procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Raporti thekson se nuk ka qenë e mundur të sigurohen të dhëna nga viktimat dhe, si alternativë, janë përdorur perceptimet e lehtësuesve të Programit për sjelljen dhe progresin e pjesëmarrësve.¹⁰² Edhe pse raporti konsideron se kombinimi i të dhënave nga kryerësit dhe lehtësuesit ka ofruar informacion të vlefshëm për rezultatet e Programit, mungesa e perspektivës së viktimave vazhdon të përbëjë një kufizim të rëndësishëm metodologjik.¹⁰³ Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se qëllimi përfundimtar i Programit është rritja e sigurisë së viktimave dhe parandalimi i përsëritjes së dhunës.

Sa i përket rezultateve të Programit, raporti evidenton përmirësime në disa fusha. Sipas gjetjeve, si pjesëmarrësit ashtu edhe lehtësuesit kanë raportuar ulje të sjelljeve abuzive emocionale, fizike dhe seksuale deri në fund të Programit.¹⁰⁴ Gjithashtu, pjesëmarrësit kanë raportuar rritje të vetëdijesimit për ndikimin e dhunës ndaj viktimave dhe përmirësime në aftësitë prindërore.¹⁰⁵ Megjithatë, raporti thekson se forma të caktuara të sjelljeve abuzive kanë vazhduar të jenë të pranishme edhe pas përfundimit të Programit, veçanërisht xhelozia, posesiviteti, kontrolli ndaj partneres dhe forma të tjera të kontrollit emocional.¹⁰⁶

Po ashtu, raporti evidenton se pjesëmarrësit kanë vazhduar të shpjegojnë përdorimin e dhunës kryesisht përmes faktorëve të jashtëm, si konsumimi i alkoolit, mungesa e besimit ndaj partneres, xhelozia apo dëshira për kontroll.¹⁰⁷ Edhe pse është vërejtur një rritje e vetëdijesimit lidhur me faktorët personalë që ndikojnë në sjelljen e tyre, raporti konstaton se qëndrimet që lidhen me fajësimin e viktimave dhe arsyetimet e jashtme për përdorimin e dhunës kanë mbetur ende të pranishme tek një pjesë e pjesëmarrësve. Për këtë arsye, raporti rekomandon vazhdimin e punës në forcimin e përgjegjësisë individuale, sfidimin e stereotipeve gjinore dhe adresimin e besimeve që legjitimojnë kontrollin dhe dhunën në marrëdhënie.¹⁰⁸

Ngjashëm me gjetjet e vitit 2024, raporti evidenton dallime të konsiderueshme ndërmjet perceptimeve të kryerësve dhe vlerësimeve të lehtësuesve sa i përket sigurisë së viktimave. Në fillim të Programit, shumica e pjesëmarrësve kanë deklaruar se (ish-)partneret e tyre nuk kishin frikë prej tyre, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e lehtësuesve kanë vlerësuar se viktimat vazhdonin të ndiheshin të rrezikuara.¹⁰⁹ Edhe në fund të Programit, shumica e pjesëmarrësve kanë deklaruar se partneret e tyre nuk kishin më frikë prej tyre, ndërsa lehtësuesit kanë shprehur rezerva

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Po aty, fq. 4 dhe 9.

¹⁰³ Po aty, fq. 16.

¹⁰⁴ Po aty, fq. 6.

¹⁰⁵ Po aty, fq. 7 dhe 9.

¹⁰⁶ Po aty, fq. 6-9.

¹⁰⁷ Po aty, fq. 6 dhe 7.

¹⁰⁸ Po aty, fq. 7-8.

¹⁰⁹ Po aty, fq. 24.

lidhur me këtë vlerësim dhe në shumë raste nuk kanë qenë në gjendje të konfirmojnë se frika e viktimave ishte eliminuar plotësisht.¹¹⁰ Raporti evidenton gjithashtu dallime ndërmjet perceptimeve të pjesëmarrësve dhe vlerësimeve të lehtësuesve edhe sa i përket ndikimit të Programit në marrëdhëniet me fëmijët dhe aftësitë prindërore.¹¹¹ Ndërsa shumica e pjesëmarrësve kanë raportuar përmirësime të konsiderueshme në këtë aspekt, vlerësimet e lehtësuesve kanë qenë më të rezervuara, duke treguar se ndryshimet e perceptuara nga kryerësit nuk përkthehen domosdoshmërisht në rritje të sigurisë dhe mirëqenies së viktimave dhe fëmijëve. Këto gjetje konfirmojnë edhe një herë rëndësinë e përfshirjes së perspektivës së viktimave në procesin e monitorimit dhe vlerësimin të Programit, si dhe nevojën për vlerësime të vazhdueshme të rrezikut dhe sigurisë.

Në aspekt të përgjithshëm, raporti për vitin 2025 paraqet gjetje që sugjerojnë ndikime pozitive të Programit në reduktimin e sjelljeve të dhunshme dhe rritjen e vetëdijesimit të pjesëmarrësve. Megjithatë, vetë raporti identifikon kufizime të rëndësishme metodologjike, përfshirë madhësinë e vogël të mostrës, ndryshimet në përbërjen e grupit gjatë zbatimit të Programit dhe mungesën e të dhënave të drejtpërdrejta nga viktimat. Për më tepër, mospërputhjet e evidentuara në të dhënat zyrtare lidhur me numrin e pjesëmarrësve dhe mungesa e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të të dhënave vazhdojnë të kufizojnë mundësinë për të vlerësuar në mënyrë të plotë dhe të besueshme efektivitetin afatgjatë të Programit dhe ndikimin e tij në parandalimin e përsëritjes së dhunës.

¹¹⁰ Po aty.

¹¹¹ Po aty, fq. 26-27.

9. Gjetjet kryesore

- Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave në Kosovë ende nuk është funksionalizuar në formën e tij të detyrueshme, por vazhdon të zbatohet vetëm mbi baza vullnetare, duke kufizuar kështu ndjeshëm shtrirjen dhe efektivitetin e tij në praktikë.
- Ekziston baza ligjore për referimin e kryerësve të dhunës në programe trajtimi dhe rehabilitimi përmes nenit 56 të Kodit Penal, mirëpo kjo mundësi nuk po shfrytëzohet në praktikën gjyqësore.
- Në praktikën gjyqësore të Kosovës, pjesa më e madhe e dënimeve për rastet e dhunës në familje janë dënime me kusht, çka krijon potencial të konsiderueshëm për referimin e kryerësve në Programin Kombëtar përmes mekanizmave ekzistues ligjorë.
- Nga 50 aktgjykimet dënuese me kusht, të analizuara nga IKD për qëllime të këtij raporti, në asnjë rast nuk është shqiptuar ndonjë nga detyrimet e parapara në nenin 56, veçanërisht detyrimi për pjesëmarrje në programe rehabilitimi. Madje, në asnjërin nga rastet nuk është dhënë arsyetim specifik lidhur me mosshqiptimin e këtyre detyrimeve, duke kufizuar kështu mundësinë për të vlerësuar nëse gjykata ka analizuar nevojat rehabilituese të kryerësit, rrezikun e përsëritjes së veprës penale, si dhe nevojën për masa shtesë që do të kontribuonin në mbrojtjen e viktimës dhe parandalimin e dhunës në të ardhmen.
- Përfaqësues të gjyqësorit kanë vlerësuar se korniza aktuale ligjore mund të forcohet përmes ndryshimeve në Kodin Penal, me qëllim që pjesëmarrja në Programin Kombëtar të parashihet si e detyrueshme në rastet e dënimeve për vepra penale që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.
- Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave është funksionalizuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe deri në momentin e hartimit të raportit 38 persona kanë qenë të përfshirë në program.
- Programi deri më tani është zbatuar vetëm në Qendrën Korrektuese të Dubravës, duke kufizuar qasjen e personave të tjerë të dënuar në këtë ndërhyrje rehabilituese.
- Shërbimi Korrektues ka ndërmarrë hapa konkretë në ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes certifikimit të zyrtarëve dhe trajnimit të stafit, me gjithsej 17 zyrtarë të certifikuar, duke krijuar parakushte për zgjerimin e programit në institucionet e tjera korrektuese.
- Shërbimi Sprovues ka 3 zyrtarë të certifikuar për zbatimin e Programit Kombëtar, mirëpo programi ende nuk është operacionalizuar në praktikë dhe nuk ka pasur asnjë pjesëmarrës të përfshirë në të.
- Mungesa e referimit nga gjykatat dhe mungesa e operacionalizimit të Programit në Shërbimin Sprovues përbëjnë dy faktorë të ndërlidhur që kufizojnë ndjeshëm efektivitetin dhe shtrirjen e Programit.
- Në praktikën gjyqësore të Kosovës, numri më i madh i dënimeve të shqiptuara për rastet e dhunës në familje janë dënime me kusht. Në këtë kontekst, fakti që Programi aktualisht zbatohet vetëm në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës nënkupton se pjesa dërrmuese e personave të dënuar për dhunë në familje dhe forma të tjera të dhunës ndaj

grave nuk i nënshtrohen këtij programi rehabilitues. Si rezultat, kjo situatë për IKD-në ngre shqetësime edhe nga perspektiva e sigurisë së viktimave, pasi shumica e kryerësve që mbeten në komunitet nuk kanë qasje në një program të strukturuar dhe të specializuar që synon ndryshimin e sjelljeve të dhunshme.

- Pjesëmarrja në programet për kryerësit e dhunës nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si alternativë ndaj ndjekjes dhe procedimit penal të veprave të dhunës.
- Zhvillimi dhe funksionalizimi i programeve për kryerësit e dhunës nuk duhet të realizohet në dëm të shërbimeve për viktimat. Në përputhje me standardet e Konventës së Stambollit dhe qasjen e orientuar drejt sigurisë së viktimave, financimi i programeve për kryerësit duhet të sigurohet në mënyrë të tillë që të mos cenojë, zvogëlojë apo ndikojë negativisht në buxhetin dhe kapacitetet e shërbimeve të dedikuara për viktimat e dhunës. Sigurimi i mbështetjes, mbrojtjes dhe fuqizimit të viktimave duhet të mbetet prioritet parësor i politikave publike dhe i alokimit të burimeve financiare.
- Në Kosovë mungon një akt nënligjor i vlefshëm që rregullon organizimin, standardet, monitorimin dhe zbatimin e Programit në kontekstet institucionale dhe komunitare.
- Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore ka paraparë nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse nga Qeveria e Republikës së Kosovës gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mirëpo deri më tani nuk janë ndërmarrë hapa konkretë për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor lidhur me trajtimin psiko-social të kryerësve të dhunës.
- Ministria e Drejtësisë nuk ka krijuar një bazë të veçantë dhe të dedikuar të të dhënave për monitorimin e kryerësve që kanë ndjekur Programin, siç parashihet në dokumentet strategjike. Databaza Nacionale për Evidentimin e Rasteve të Dhunës në Familje përmban vetëm të dhëna bazike dhe nuk mundëson monitorimin e progresit, rezultateve dhe efektivitetit të Programit.
- Raportet vjetore të monitorimit dhe vlerësimit të Programit nuk janë publikuar nga Ministria e Drejtësisë. Mungesa e publikimit të tyre cenon transparencën, llogaridhënien dhe mundësinë për monitorim e vlerësim të pavarur të efektivitetit të programit.
- Analiza e raporteve të vlerësimit për vitet 2024 dhe 2025 ka evidentuar mospërputhje ndërmjet burimeve të ndryshme institucionale lidhur me numrin e pjesëmarrësve në Program, duke ngritur shqetësime për konsistencën dhe besueshmërinë e raportimit.
- Raportet e vlerësimit identifikojnë kufizime metodologjike të rëndësishme, përfshirë madhësinë e vogël të mostrës, ndryshimet në përbërjen e grupeve gjatë zbatimit të Programit dhe pamundësinë për të matur në mënyrë të qëndrueshme ndryshimet individuale të pjesëmarrësve përgjatë kohës.
- Perspektiva e viktimave nuk është pjesë e vlerësimit të rezultateve të Programit.
- Në mungesë të të dhënave të drejtpërdrejta nga viktimat, procesi i vlerësimit të Programit është mbështetur kryesisht në vetëvlerësimin e kryerësve dhe perceptimet e lehtësuesve, ndërkohë që raportet evidentojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet këtyre dy burimeve lidhur me sigurinë e viktimave dhe ndikimin e Programit.

- Megjithëse raportet evidentojnë përmirësime në reduktimin e sjelljeve të dhunshme dhe rritjen e vetëdijesimit të pjesëmarrësve, forma të caktuara të kontrollit, xhelozisë, posesivitetit, stereotipeve gjinore dhe fajësimit të viktimave vazhdojnë të jenë të pranishme tek një pjesë e pjesëmarrësve edhe pas përfundimit të Programit.
- Praktikrat ndërkombëtare tregojnë se efektiviteti i programeve për kryerësit e dhunës është i lidhur ngushtë me ekzistimin e procedurave të standardizuara të monitorimit, trajnimit e vazhdueshëm të zyrtarëve dhe vlerësimin e pavarur të rezultateve.

10. Rekomandimet

1. Gjykatat ta rrisin përdorimin e detyrimeve të parapara në nenin 56 të Kodit Penal në rastet e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, veçanërisht referimi i kryerësve në programe rehabilitimi si Programi Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë të organizojnë trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët lidhur me Programin Kombëtar për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave, rëndësinë e tij në parandalimin e recidivizmit dhe mbrojtjen e viktimave dhe përdorimin e nenit 56 të Kodit Penal.
3. Prokurorët e shtetit, mbrojtësit e viktimave dhe akterët e tjerë relevantë të adoptojnë një qasje më proaktive në propozimin e referimit të kryerësve në programe trajtimi dhe rehabilitimi kur shqiptohet dënimi me kusht.
4. Të sigurohet funksionalizimi i Programit në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës dhe përfshirja e personave të dënuar me kusht dhe personave të tjerë nën mbikëqyrje.
5. Shërbimi Korrektues i Kosovës të zgjerojë zbatimin e Programit Kombëtar në të gjitha institucionet korrektuese ku ndodhen persona të dënuar për dhunë në familje dhe dhunë ndaj grave.
6. Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës të vazhdojnë investimin në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit.
7. Ministria e Drejtësisë, përmes Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, të hartojë dhe propozojë për miratim aktin nënligjor që rregullon organizimin, standardet, monitorimin dhe zbatimin e Programit për Kryerësit e Dhunës ndaj Grave.
8. Ministria e Drejtësisë të publikojë raporte të rregullta vjetore mbi zbatimin, rezultatet dhe sfidat e Programit Kombëtar.
9. Monitorimi dhe vlerësimi i Programit të bazohet në procedura të standardizuara dhe të përfshijë matjen e rezultateve para, gjatë dhe pas përfundimit të trajtimit.
10. Monitorimi dhe vlerësimi i Programit duhet të përfshijë, aty ku është e mundur dhe e sigurt, edhe perspektivën e viktimave lidhur me ndryshimet e vërejtura në sjelljen e kryerësit dhe nivelin e sigurisë së tyre.
11. Ministria e Drejtësisë të krijojë një sistem të unifikuar dhe të standardizuar për mbledhjen, menaxhimin dhe raportimin e të dhënave mbi Programin, duke siguruar konsistencë

ndërmjet të dhënave të Shërbimit Korrektues, Shërbimit Sprovues, Zyrës së Koordinatorit Kombëtar dhe raporteve të vlerësimit.

12. Ministria e Drejtësisë të organizojë trajnime të vazhdueshme për stafin përgjegjës përkitazi me metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të rezultateve të punës së tyre.
13. Ministria e Drejtësisë të zhvillojë instrumente të standardizuara për monitorimin dhe vlerësimin e Programit, duke mundësuar krahasimin e rezultateve para, gjatë dhe pas përfundimit të trajtimit, si dhe matjen e ndryshimeve individuale të pjesëmarrësve përgjatë kohës.
14. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore si ZMNV, por edhe organizatat e specializuara që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës, të zhvillojë mekanizma të sigurt dhe etikë për përfshirjen e perspektivës së viktimave në monitorimin dhe vlerësimin e rezultateve të Programit.
15. Me rastin e planifikimit buxhetor, të sigurohet një ndarje e veçantë dhe e qëndrueshme buxhetore për zbatimin e Programit, duke garantuar çdo herë që financimi i këtij programi të mos realizohet në dëm të fondeve të dedikuara për mbrojtjen, rehabilitimin, strehimin dhe fuqizimin e viktimave të dhunës.
16. Të sigurohet koordinim i rregullt ndërinstitucional ndërmjet gjykatave, prokurorive, Shërbimit Sprovues, Shërbimit Korrektues, Zyrës së Koordinatorit Kombëtar dhe organizatave të specializuara që ofrojnë shërbime për viktimat dhe kryerësit e dhunës.

